

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XVIII, nr. 5664
E enjte, 27 dhjetor 2018
çmimi 0.40 €

Haradinaj kërkon të ulët çmimi i naftës

FAQE 9



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

PRESIDENTI I VENDIT, HASHIM THAÇI, KA MBAJTUR FJALIMIN VJETOR PARA DEPUTETËVE TË KUVENDIT TË KOSOVËS

FAQE 4-5

Thaçi, deputetëve: Është koha ta fitojmë paqen me Serbinë

Presidenti Hashim Thaçi ka thënë se shteti i Kosovës e ka përkrahjen botërore për ta arritur marrëveshjen përfundimtare me Serbinë. Ai ka thënë se kjo marrëveshje duhet t'ia sjellë Kosovës njohjen nga Serbia dhe anëtarësimin në Kombet e Bashkuara. Thaçi ka theksuar se pas arritjes së marrëveshjes rajoni dhe Evropa do të kenë paqe dhe stabilitet të qëndrueshëm. Gjatë adresimit vjetor në Kuvend, presidenti u ka thënë deputetëve se tani është koha që Kosova ta fitojë paqen me Serbinë dhe, sipas Thaçit, humbja e këtij rasti do të ishte kthim tragjik prapa.



Ekipi negociator më 8 janar do të shkojë në Bruksel

FAQE 3



Ekipi negociator i Kosovës do të udhëtojë në Bruksel më 8 janar të vitit të ardhshëm është bërë me dije të mërkurën pas takimit të këtij ekipi me presidentin, kryeministrin dhe kryeparlamentarin, i cili ishte thirrur nga ky i fundit. Zyrtarët më të lartë

shtetërorë dhe ata të ekipit negociator janë zotuar për transparencë në këtë proces. Gjithashtu, ata i kanë ftuar edhe dy partitë e tjera opozitare, Lidhjen Demokratike të Kosovës (LDK) dhe Lëvizjen Vetëvendosje, që t'i bashkohen ekipit negociator.



**Rama: FSK-ja
po ndërtohet
mbi bazën e
standardeve
të NATO-s**

FAQE 7

AKTUALE

DIALOGU NË KTHETRAT E FORMATIT

F. 10

Shkruan:
Blerim MURIQI



QALAJ TAKOHET ME DREJTORËT E POLICIVE TË SHQIPËRISË DHE TË MAQEDONISË

F. 6

DËSHTON SEANCA E OPOZITËS, LDK-JA DHE LV-JA KRITIKOJNË PUSHTETIN

F. 5


EKONOMI

ARBITRAZHI TË PËRDORËT PËR ZGJIDHJET E KONTESTEVE NË PROKURIMIN PUBLIK

F. 9

MINISTRI ENDRIT SHALA VIZITOI KOMPANINË 'M-TECHNOLOGIE'

F. 9



SPORT



DONJETA SADIKU DHE PATRIOT BEHRAMI, MË TË MIRËT PËR VITIN 2018

F. 16

GREZDA: JAM SHUMË I LUMTUR TE RANGERSI

F. 16

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepcisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijibiznesi.com
info@kolegijibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Xhaferi president shteti nëse nuk ka census në zgjedhje

SHKUP, 26 DHJETOR - Nëse nuk sigurohet një census prej 40 % të votuesve për ta zgjedhur presidentin e Maqedonisë në raundin e dytë të zgjedhjeve të ardhshme, atëherë Talat Xhaferi do ta marrë përsipër postin e

presidentit. Kurse pastaj nëpërmjet ndryshimeve të reja kushtetuese që do t'i nisë qeveria, kreu i shtetit do të zgjidhet në Kuvend, njoftojnë burime qeveritare, transmeton "Zhurnal".

Në vend të zgjedhjeve të drejtpërdrejta në të cilën njerëzit duhet të vendosin se kush do ta udhëheqë vendin, qeveria mendon se vetëm me shumicën në Kuvend mund të arrijnë presidentin. Sipas afateve

ligjore, më 2 ose 3 shkurt, Xhaferi ka njoftuar tashmë se duhet të publikohet vendimi për mbajtjen e zgjedhjeve të rregullta presidenciale. Pasi që mandati i presidentit Gjorge Ivanov përfundon më 12 maj,



pritet që zgjedhjet të mbahen në fund të muajit mars ose në fillim të muajit prillit.

Zgjedhjet e parakohshme në Maqedoni nuk i konvenojnë askujt

Analistët thonë se organizimi i zgjedhjeve të parakohshme parlamentare në Maqedoni nuk është në interes as të partive politike në pushtet, as në favor të opozitës maqedonase e cila tani është më shumë se kurdoherë e përçarë

SHKUP, 26 DHJETOR - Analistët në Maqedoni thonë se organizimi i zgjedhjeve të parakohshme parlamentare nuk është në interes as të partive politike në pushtet të cilat presin të bëhen të dukshme rezultatet e politikave të Qeverisë pasi të përfundojë procesi i zgjidhjes së kontestit me Greqinë për çështjen e emrit, e as në favor të opozitës maqedonase e cila tani është më shumë se kurdoherë e përçarë.

Idea për organizimin e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare është diskutuar në opinion si mundësi për ta arritur censusin e nevojshëm për zgjedhjen e presidentit të shtetit prej 40 përqindësh, në rast se opozita në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të fshehtë bojkoton zgjedhjet si në rastin e referendumit për marrëveshjen për emrin.

Kryeministri i Maqedonisë, Zoran Zaev ka refuzuar gjatë së mërkurës ta komentojë çështjen e censusit, duke theksuar se është i fokusuar te ndryshimet kushtetuese, të cilat, siç është shprehur ai, kanë peshën më të madhe për momentin. "Besoj se pas festave dhe pas seancës që është caktuar më 9 janar, atëherë do të hapim këto tema dhe do t'u përgjigjemi këtyre pyetjeve. Por, përgjigjja ime

është se besoj se 40 për qind e censusit do të arrihet në këtë sfidë konkurruese mes më shumë kandidatëve, jo vetëm Qeveri dhe opozitë, ose majtistët dhe djathtistët", është shprehur Zaevi.

Kryeministri i Maqedonisë, Zoran Zaev, disa herë ka theksuar se ai personalisht është kundër mbajtjes së zgjedhjeve të parakohshme parlamentare sepse ato, sipas tij, do t'i bllokoni reformat ekonomike, njëherësh do ta frenonin procesin e integritetit të shtetit në familjen evropiane.

Edhe lideri i partisë shqiptare në pushtet, Bashkimit Demokratik për Integritet (BDI), Ali Ahmeti, në një intervistë për "Radion Evropa e Lirë" kishte deklaruar se Maqedonisë nuk i duhen zgjedhjet e parakohshme parlamentare. Përderisa nga partia maqedonase në opozitë, VMRO-DPMNE, nuk janë përgjigjur konkretisht nëse janë për ose kundër zgjedhjeve të parakohshme, duke thënë se kjo parti është e gatshme të ballafaqohet me popullin nëse ato eventualisht organizohen. "Ne jemi të gatshëm si parti për zgjedhje parlamentare pavarësisht se kur ata do të organizohen. Nuk i ikim ballafaqimit me popullin", kanë thënë nga



VMRO-ja.

Ndërkaq Mitko Gaxhoski, njohtës i çështjeve politike, thotë se Maqedonia si shtet asgjë të mirë nuk do të mund të fitojë me organizimin eventual të zgjedhjeve të parakohshme parlamentare bashkë me ato presidenciale në pranverë të vitit të ardhshëm përpos që do të humbasë kohë e cila është shumë e çmuar për realizimin e reformave. "Mendoj se opsioni për organizimin e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare më së paku i konvenon pushtetit, partive në opozitë. E them këtë sepse të gjitha rezultatet nga realizimi i politikave të caktuara pritet të bëhen të dukshme pas realizimit të procesit për zgjidhjen e çështjes së emrit. Për këtë arsye nuk besoj

se do të mbahen zgjedhjet e parakohshme parlamentare, bashkë me ato presidenciale", thotë Gaxhoski.

Në anën tjetër, eksperti i ekonomisë, Visar Ademi, thotë se organizimi i zgjedhjeve të parakohshme parlamentare, bashkë me ato presidenciale, do t'i shpërqendrojë drejtuesit e shtetit nga zgjidhja e problemeve ekonomike. "Nëse do të mbahen zgjedhjet e parakohshme parlamentare bashkë me ato presidenciale, kjo do të ketë ndikim të drejtpërdrejtë në shpenzimet nga buxheti sepse, pikë së pari, ato nuk janë të planifikuara dhe ky është efekti i drejtpërdrejtë", tha ai. "Kurse efekti indirekt është shumë më i madh sepse dy vjetët e para, Qeveria e

Zoran Zaevit ishte e fokusuar në stabilitetin dhe qëndrueshmërinë e institucioneve politike dhe nuk është se kemi pasur fokus në ekonomi", thotë Ademi.

Ndryshe, burime të Qeverisë kanë bërë me dije se në rast se opozita vendos t'i bojkotojë zgjedhjet do të diskutohet edhe mundësia që Qeveria të iniciojë ndryshime të reja kushtetuese për zgjedhjen e presidentit të Maqedonisë nga Parlamenti. Ndërkohë, kryetari i Parlamentit të Maqedonisë, Talat Xhaferi, të martën ka bërë me dije se më 2 ose 3 shkurt të vitit të ardhshëm do t'i shpallë zgjedhjet presidenciale të cilat do të duhet të mbahen kah fundi i marsit ose në fillim të prillit të vitit të vitit 2019.

Ndryshimet në Qeveri, Rama mbledh Asamblenë e PS-së

TIRANË, 28 DHJETOR - Mësohet se Asambleja Kombëtare e Partisë Socialiste që do të mbledhet nesër (e premte) do të nisë me fjalën e kryetarit të PS-së, Edi Rama, i cili do të bëjë një analizë të qeverisë së tij në një vit, por me fokus ngjarjet e fundit. Gjatë kësaj fjale pritet të bëhen pub-

like edhe vendimet e tij për lëvizjet në kabinetin e tij.

Më pas, Asambleja do të hyjë në proceset organizative të PS-së, e kryesisht me hapjen e partisë për më shumë të rinj dhe gra. Mësohet se Asambleja do të miratojë një propozim për të përfshirë në çdo organizatë dhe

forum të PS-së 30 për qind gra dhe 30 për qind të rinj. Edhe pse kjo përqindje është vendosur pa u kthyer në normë që kur u vendosën kriteret gjinore në listat e deputetëve dhe këshilltarëve bashkiakë, ky vendim do t'i hapë rrugë një ripërtëritje të organizatave socialiste, ku të rin-

jë dhe gratë do t'i dominojnë organizatat me 60 për qind të tyre me prurje të reja. Kjo duket se do të jetë masa e parë për ta mbyllur hendekun mes PS-së dhe qytetarëve, një nga shqetësimet e ngritura në Kryesinë socialiste disa ditë më parë e që lidhej me perceptimin



e dobët të qytetarëve ndaj reformave të qeverisë dhe shpëputjes së PS-së nga qytetarët.

Është mbajtur takimi i parë i liderëve institucionalë me ekipin negociator të Kosovës për bisedime me Serbinë

Ekipi negociator më 8 janar do të shkojë në Bruksel



Ekipi negociator i Kosovës do të udhëtojë në Bruksel më 8 janar të vitit të ardhshëm është bërë me dije të mërkurën pas takimit të këtij ekipi me presidentin, kryeministrin dhe kryeparlamentarin, i cili ishte thirrur nga ky i fundit. Zyrtarët më të lartë shtetërorë dhe ata të ekipit negociator janë zotuar për transparencë në këtë proces. Gjithashtu, ata i kanë ftuar edhe dy partitë e tjera opozitare, Lidhjen Demokratike të Kosovës (LDK) dhe Lëvizjen Vetëvendosje, që t'i bashkohen ekipit negociator

e delegacionit shtetëror si dhe ka sponsorizuar hartimin e draft-marrëveshjes, librin e madh me shumë kapituj, që është shkruar nga ekspertët e Qeverisë, duke e pajisur ekipin negociator të vendit me një materie të gjallë, gjithëpërfshirëse dhe të hapur", ka thënë Haradinaj, duke shtuar se mirëpret çdo ide dhe sugjerim rreth dialogut Kosovë - Serbi por, sipas tij, asnjëherë në tavolinat e bisedimeve nuk do të flitet apo negociohet për shkëmbim të territoreve.

Ndërsa bashkëkryesuesi i ekipit negociator, kryetari i PSD-së, Shpend Ahmeti, ka treguar se shumë shpejt do të dihen për publikun temat që do të diskutohen në takimin e parë të Brukselit. "Ne do të kemi transparencë të plotë në këtë proces mbi atë se çfarë po diskutohet. Më 8 janar jemi të ftuar në Bruksel që të informohemi për platformat dhe temat", ka thënë Ahmeti, duke përmendur disa prej temave që do të diskutohen në këtë proces. "Shumë shpejt do ta kemi edhe matricën e të gjitha temave që ne i presim që do të zgjidhen në këtë dialog gjithëpërfshirës. Pra, do të jenë të përfshira në platformë tema e të zhdukurve, dëmet e luftës dhe të pronave", ka deklaruar Ahmeti.

Në këtë takim nuk kanë marrë pjesë zyrtarët e LDK-së dhe të LV-së të cilët kanë qenë të ftuar nga kryeparlamentari Veseli. Në këtë takim nuk ka marrë pjesë as bashkëkryesuesi tjetër i delegacionit, lideri i Nismës Socialdemokrate Fatmir Limaj, i cili ka qenë jashtë vendit. Ishte dakordim i përbashkët që

takimet e tilla të zhvillohen edhe në të ardhmen, në funksion të ecurisë sa më të mirë të procesit të dialogut dhe informimit të plotë përkitazi me të.

Kryeparlamentari Kadri Veseli i ka ftuar sërish krerët institu-

cionalë dhe ekipin negociator në një takim tjetër që do të mbahet të enjten në orën 10:00, e ku do të ftohen të marrin pjesë edhe ambasadorët e vendeve në Quintit dhe përfaqësuesja e Zyrës së Bashkimit Evropian.

Rreth 20 mijë lëndë të trajtuara nga Prokuroria e Mitrovicës në vitin 2018

MITROVICË, 26 DHJETOR (ER) - Prokuroria Themelore në Mitrovicë ka mbajtur të mërkurën kolegjin e fundit për vitin 2018 të prokurorëve të kësaj prokurorie, me pjesëmarrjen e Laura Pulës, prokurore e Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, e cila është caktuar mbikëqyrëse për Prokurorinë Themelore të Mitrovicës.

Gjatë këtij takimi janë diskutuar tema të ndryshme të punës së përditshme të Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, raporti mujor i punës për të gjithë prokurorët, shqyrtimi i realizimit të planit vjetor të punës, si dhe sfidat me të cilat përballlet kjo prokurori për kry-

erjen e punëve të përditshme. Kryeprokurori Shyqyri Sylja ka thënë se është shumë i kënaqur me punën e kryer nga prokurorët e këtij institucioni, shumica e objektivave të caktuara në fillim të vitit janë tejkaluar dhe mbi 90 për qind të akuzave të përpiluara nga ky institucion kanë kaluar nëpër gjykatat e regjionit të cilin e mbulon kjo prokurori. Gjithashtu, rezultat i kënaqshëm është fakti se rreth 20 000 lëndë janë trajtuar nga kjo prokurori në vitin 2018, përfshirë këtu lëndë të të gjitha natyrave të përfunduara në këtë prokurori dhe nëpër stacione policore.



**EPOKA
ERE** **Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 26 DHJETOR - Udhëheqësit e institucioneve të Kosovës dhe ekipi negociator për dialog me Serbinë kanë zhvilluar të mërkurën takimin e parë të përbashkët, ku kanë diskutuar për hapat e ardhshëm në kuadër të fazës finale të dialogut Kosovë - Serbi. Pas takimit të thirrur nga kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, është bërë me dije se ekipi negociator do të udhëtojë për herë të parë për në Bruksel më 8 janar të vitit të ardhshëm.

Nikoqiri i këtij takimi është zotuar se ky proces do të jetë transparent, duke theksuar se qëllimi i këtij dialogu është njohja e Kosovës nga Serbia dhe anëtarësimi i Kosovës në OKB. "Është proces i lirisë, i sovranitetit të territorit të shtetit tonë të pavarur dhe sovran, është proces që Serbia ta njohë Kosovën shtet dhe ta fitojmë ulësen në OKB. I tërë procesi është transparent. Kosova e ka zotimin e vet për dialog para institucioneve, para qytetarëve dhe para partnerëve ndërkombëtarë. Kosova ka njerëzit e vet

që do t'i dalin zot vendit të vet", ka thënë Veseli. Ai deklaruar se asnjëherë nuk do të heqin dorë nga qytetarët e Luginës së Preshevës. "Presheva, Medvegja dhe Bujanoci janë shqiptarë dhe ne nuk heqim dorë nga ata. Por, nuk kemi pretendime as për shkëmbime territore, as për korrigjim", është shprehur Veseli.

Kurse presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka ftuar edhe subjektet e tjera opozitare që t'i bashkëngjiten këtij procesi. Sipas tij, koordinimi i spektrit politik do ta bëjë të suksesshëm këtë proces. "Ky unitet i qëndrueshëm i bartësve të institucioneve, ekipit negociator, shoqërisë civile, është një thirrje edhe për hezituesit e këtij procesi që të marrin përgjegjësi për përmbylljen e fazës finale të dialogut Kosovë - Serbi", ka deklaruar Thaçi.

Ndërkaq kryeministri Ramush Haradinaj ka deklaruar se qeveria e vendit do të jetë çdoherë në mbështetje të këtij ekipi. "Qeveria e vendit, me qëllim që ekipi negociator të vihet në kornizë ligjore, ka miratuar projektligjin për detyrat, përgjegjësitë dhe kompetencat

Presidenti i vendit, Hashim Thaçi, ka mbajtur fjalimin vjetor para deputetëve të Kuvendit të Kosovës

Thaçi, deputetëve: Është koha



Presidenti Hashim Thaçi ka thënë se shteti i Kosovës e ka përkrahjen botërore për ta arritur marrëveshjen përfundimtare me Serbinë. Ai ka thënë se kjo marrëveshje duhet t'ia sjellë Kosovës njohjen nga Serbia dhe anëtarësimin në Kombet e Bashkuara. Thaçi ka theksuar se pas arritjes së marrëveshjes rajoni dhe Evropa do të kenë paqe dhe stabilitet të qëndrueshëm. Gjatë adresimit vjetor në Kuvend, presidenti u ka thënë deputetëve se tani është koha që Kosova ta fitojë paqen me Serbinë dhe, sipas Thaçit, humbja e këtij rasti do të ishte kthim tragjik prapa. Duke u zotuar për vazhdimin e dialogut dhe arritjen e marrëveshjes, Thaçi ka thënë se Kosova pret me padurim bekimin e kësaj marrëveshje në Shtëpinë e Bardhë nën lidërsipin e president amerikan Donald Trump

**EPOKA
ERE****Shqipe HETEMI**

PRISHTINË, 26 DHJETOR - Presidenti Hashim Thaçi të mërkurën ka mbajtur fjalimin vjetor para deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës, ku ka mirëpritur faktin se spektri politik kosovar ka filluar të bëhet bashkë rreth sfidës për arritjen e marrëveshjes paqësore me Serbinë. Ai u ka thënë deputetëve se tani është koha që shteti i Kosovës ta fitojë paqen me Serbinë. Sipas Thaçit, kjo marrëveshje duhet t'ia sjellë Kosovës njohjen nga Serbia dhe anëtarësimin në Kombet e Bashkuara. "Me Serbinë kemi një shekull armiqësi. E kemi fituar luftën, ndonëse me çmim të lartë. Tani është koha ta fitojmë edhe

paqen me Serbinë. Për veten tonë dhe për gjeneratat që do të vijnë. Prandaj e mirëpres themelimin e ekipit negociator nga Kuvendi i Kosovës dhe fillimin e punës për marrëveshjen me Serbinë. Kjo marrëveshje duhet të jetë përfundimtare, gjithëpërfshirëse, e arritur në proces paqësor e të ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian dhe mbështetur plotësisht nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Kjo marrëveshje duhet t'ia sjellë Kosovës njohjen nga Serbia dhe anëtarësimin në Kombet e Bashkuara. Ndërsa, rajonit dhe Evropës, do t'ia sjellë paqe të qëndrueshme dhe stabilitet", është shprehur Thaçi. Ai ka thënë se Republika e Kosovës e ka përkrahjen e botës për të arritur marrëveshje paqësore, përfundimtare dhe

gjithëpërfshirëse me Serbinë. Prandaj, sipas Thaçit, humbja e këtij rasti do të ishte kthim tragjik prapa. "Dy letra të arritura në zyrën time këtë muaj tregojnë se jemi në rrugë të drejtë. Letra e presidentit

Macron të Francës e lavdëron angazhimin tonë për paqe dhe stabilitet. Por, edhe më e fuqishme është letra e presidentit Trump, e shtetit tonë më të afërt. I jemi mirënjohës që në letrën e tij presidenti Trump e

dallon Kosovën si partner vendimtar për paqen dhe zhvillimin në tërë kontinentin e Evropës. Duhet ta marrim me seriozitetin më të thellë ftesën e presidentit Trump kur thotë që 'ju nxis dhe liderët e Kosovës ta

Thaçi e quan të dhimbshëm mospranimin e Kosovës në Interpol dhe mosliberalizimin e vizave

Kryetari i shtetit ka thënë se 2018-ta është karakterizuar me momente të rënda siç kanë qenë mosanëtarësimi në Interpol dhe shtyrja e liberalizimit të vizave. "Dhimbje kemi përjetuar edhe nga mospranimi i Kosovës në Interpol, por edhe

për shkak të vonimit të vendimit për liberalizimin e vizave për qytetarët tanë nga ana e BE-së. Jam krenar që si shtet kemi bërë çdo gjë që është kërkuar nga ne. Kemi plotësuar çdo kriter edhe për anëtarësim në Interpol, edhe për liberalizim të vizave.

Mungesa e vendimit të drejtë në këto dy raste nuk është humbje për ne. Por, nuk është as dekurajim që ta vazhdojmë forcimin e shtetit tonë. Këtë e bëjmë sepse, mbi të gjitha, është në interesin dhe në dobinë tonë", ka theksuar ai.

ta fitojmë paqen me Serbinë



Thaçi: Këtë vit kemi humbur Adem Demaçin dhe Fadil Vokrrin

Presidenti Hashim Thaçi ka thënë se viti 2018 i ka sjellë disa humbje. Sipas tij, këtë vit Kosova ka humbur dy figura të çmuara të kombit, Adem Demaçin dhe Fadil Vokrrin. "Nuk ka fjalë që përshkruajnë këtë humbje. Do ta ruajmë dhe nderojmë kujtimin duke vazhduar të punojmë për atë që ëndëronin edhe ata", ka deklaruar Thaçi. Fjalimin vjetor të presidentit Hashim Thaçi e kanë bojkotuar Lidhja Demokratike e Kosovës, Lëvizja Vetëvendosje dhe Lista Serbe.

në shërbim të paqes në Kosovë, në rajon dhe më gjerë", është shprehur Thaçi, duke shtuar se një e arritur tjetër ka qenë edhe dekretimi i pakos së ligjeve për

reformën në sistemin e drejtësisë. "Kjo pako që përfshinë ndryshimet në Kodin Penal, Ligjin për Gjykatat, për Përgjegjësinë Disiplinore të

Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, Ligjin për Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskimin e Pasurisë dhe ligje të tjera do ta forcojë edhe më tutje sistemin tonë të drejtësisë", ka thënë ai. Thaçi ka vlerësuar se aktualisht në rajon Kosova ka zhvillimin më të shpejtë ekonomik, legjislacionin më të avancuar dhe institucionet më demokratike. Thaçi para deputetëve të Kuvendit të Kosovës ka folur edhe për përfaqësimin e vendit në arenën ndërkombëtare, me ç'rast ka thënë se në të gjitha forumet ku ka marrë pjesë e ka bërë të qartë se Kosova është e përcaktuar për dialog, për paqe, si dhe angazhohet për t'u bërë anëtare e NATO-s dhe e BE-së.

Dështon seanca e opozitës, LDK-ja dhe LV-ja kritikojnë pushtetin

PRISHTINË, 26 DHJETOR (ER) - Me kërkesë të partive opozitare, Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) dhe Lëvizjes Vetëvendosje, ishte thirrur të mërkurën në orën 10:00 seancë e jashtëzakonshme e Kuvendit, gjatë së cilës pritej të shqyrtohej një dokument për marrëveshje gjithëpërfshirëse në dialogun Kosovë - Serbi. Mirëpo seanca nuk ka filluar punimet për shkak të mungesës së deputetëve të koalicionit qeveritar. Pasi dështoi kjo seancë, LDK-ja e LV-ja kanë mbajtur një konferencë për media, në të cilën kanë adresuar kritika për mazhorancën.

Shefi i grupit parlamentar i

Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Avdullah Hoti, ka fajësuar të mërkurën kryetarin e Kuvendit, Kadri Veseli, për shkelje të Rregullores së Kuvendit për mbajtjen e seancave. "Seanca e jashtëzakonshme e Kuvendit të Kosovës, e kërkuar nga opozita, u anulua. Është obligim kushtetues që Kuvendi të mblidhet kur atë e kërkon një e treta e deputetëve. Kryetari i Kuvendit e ka obligim të krijojë kushtet për mbajtje të seancës sipas kërkesës së 40 deputetëve. Ai e pamundësoi mbajtjen e seancës duke mos e hapur seancën në orën e kërkuar, si dhe duke mos e autorizuar asnjërin nga të pesë nënkryetarët e Kuvendit", ka

thënë Hoti. Ndërsa shefi i grupit parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje, Glauk Konjufca, ka thënë se ky bojkot shpërfaq strategjinë e kësaj mazhorance. "Kemi kërkuar të shqyrtohet ky dokumenti 30 faqesh për marrëveshje gjithëpërfshirëse. Por, tash e disa herë mazhoranca po e aplikon strategjinë e bojkotit. Sot e tregoi fytyrën e vërtetë. Opozita erdhi në sallë, një orë e gjysmë prit, pushteti nuk ishte. Është papërgjegjësi. Kjo po tregon që pushteti e ka marrë drejtimin që ta shkelë opozitën në këtë mënyrë, që zëri i opozitës mos të dëgjohet", ka thënë Konjufca.



shfrytëzoni këtë moment unik' dhe 'të flisni me një zë të vetëm gjatë negociatave për paqe'. E kemi përkrahjen e mikut më të madh dhe shtetit më të fuqishëm, ShBA-së. E kemi përkrahjen e BE-së dhe të shteteve anëtare të saj. E kemi përkrahjen e botës për të arritur marrëveshje paqësore, përfundimtare dhe gjithëpërfshirëse me Serbinë. Të humbim këtë rast, siç thotë edhe presidenti Trump në letrën e tij, do të ishte kthim tragjik prapa dhe do të humbim një mundësi që nuk do të përsëritet edhe një kohë të gjatë", ka deklaruar Thaçi.

Duke shprehur zotimin për vazhdimin e dialogut dhe arritjen e marrëveshjes, Thaçi ka thënë se Kosova pret me padurim bekimin e kësaj marrëveshjeje në Shtëpinë e Bardhë nën lidërshpinin e president amerikan Donald Trump. "Si president i Kosovës nga foltorja e Kuvendit të Republikës së Kosovës, në emër të qytetarëve dhe lidërshpit të Kosovës, konfirmoj se Kosova është gati për dialog. Kosova zotohet se do ta arrijë mar-

rëveshjen finale me Serbinë. Lidërshpi dhe qytetarët e Kosovës presin me padurim bekimin e kësaj marrëveshjeje në Shtëpinë e Bardhë, nën lidërshpinin tuaj president Trump", ka theksuar presidenti Thaçi. Më tutje, shefi i shtetit para deputetëve ka prezantuar të arriturat e Kosovës gjatë këtij viti jubilar, duke thënë se transformimi i FSK-së në ushtri ka qenë suksesi më i madh. "Jam ndier veçanërisht i lumtur dhe krenar që tek unë kanë arritur për dekretim tri ligjet me të cilat hapet rruga që Forca e Sigurisë së Kosovës të bëhet ushtri e Kosovës. Shpesh jam ndier i vetmuar në angazhimin tim për themelimin e ushtrisë së Kosovës. Por, jam i lumtur që më në fund i tërë spektri politik i Kosovës u bë bashkë rreth këtij synimi për transformimin e FSK-së. Ushtarët e FSK-së e kanë merituar qëmoti këtë. Me punën e tyre, me profesionalizmin e tyre, ata qëmoti janë ushtarë të Kosovës. FSK-ja do të vazhdojë të mbetet forcë profesionale e standardeve të NATO-s, forcë shumetnike, në shërbim të të gjithë qytetarëve dhe

MSh-ja: Në vitin 2019 parashihet rritja e pagave në sektorin e shëndetësisë

PRISHTINË, 26 DHJETOR (ER) - Në institucionet publike shëndetësore, në tre nivelet, të mërkurën ka filluar greva 24-orëshe e organizuar nga Federata e Sindikatave të Shëndetësisë. Kryetari i Federatës, Blerim Syla, ka thënë se kërkesa e tyre e vetme është miratimi i Projektligjit të ri për pagat sipas kërkesave të tyre. Kryesia e Sindikalistëve të Shëndetësisë ka deklaruar se grevës i janë përgjigjur të gjitha institucionet publike shëndetësore dhe deri më tani gjithçka ka qenë në rregull. Syla ka thënë se, përveç deputetëve të Komisionit Parlamentar për Shëndetësi, deri më tani nuk i ka kontaktuar asnjë institucion tjetër për kërkesat e tyre. "Deri më tani nuk na ka kontaktuar askush, përveç deputetëve të Komisionit për Shëndetësi. Kjo është për të ardhur keq

dhe brenga jonë është se nëse vazhdon kjo neglizhencë dhe injorim, FSSHK do ta mbledhë këshillin qendror grevist i cili do ta ndërrojë vendimin për grevën 24-orëshe. Nëse dikush nga Qeveria apo Kuvendi nuk reflekton, atëherë ka mundësi që greva do të vazhdojë edhe në ditët në vazhdim", ka deklaruar Syla. Ministria e Shëndetësisë (MSh) përmes një njoftimi për media ka bërë me dije se është duke e përcjell me vëmendje grevën e punonjësve shëndetësorë dhe ka theksuar se gjatë këtij viti ka punuar për kërkesat e tyre. "Për këtë qëllim, është punuar në Projektligjin për pagat në sektorin publik, të cilin e ka miratuar Qeveria e Republikës së Kosovës dhe të njëjtin e ka dërguar në Kuvend. Tani MSh-ja pret të miratohet buxheti për vitin 2019 dhe t'i hapet rruga për



kalim në Kuvend edhe Projektligjit për pagat në sektorin publik. Me buxhetin për vitin 2019 parashihet rritja e pagave në sektorin shëndetësor", është bërë me dije në njoftimin e MSh-së. "Krahas

angazhimeve të tjera, në këto momente duhet të mendojmë dhe të kujdesemi edhe për gjendjen dhe trajtimin korrekt të pacientëve tanë, duke u angazhuar njëkohësisht që të sigurohet më e mira edhe për

profesionistët shëndetësorë të të gjitha niveleve. MSh konsideron se të gjitha problemet mund të zgjidhen përmes bashkëpunimit dhe dialogut social", është thënë në njoftimin e MSh-së.

Myftiu Tërnavë: Ushtria është garanci për paqen dhe sigurinë e Kosovës



**EPOKA
ERE**

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 26 DHJETOR - Ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), Rrustem Berisha, ka pritur të mërkurën në takim kryetarin e Bashkësisë Islame të Kosovës (BIK), myftiun Naim Tërnavë. Fillimisht Tërnavë ka përgëzuar Berishën për formimin e ushtrinë, e cila, siç ka thënë ai, "është garanci e fortë për paqen dhe sigurinë e vendit tonë dhe rajonit". Ai ka thënë se BIK-u do të vazhdojë të kontribuojë për forcimin e ushtrisë. "Zoti ju ndihmoftë në rrugën tuaj për ndërtimin e kapaciteteve të plota ushtarake. Na ka gëzuar pa masë edhe përkrahja e miqve tanë

ndërkombëtarë në krye me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Mbretërinë e Bashkuar, Gjermaninë dhe miqtë e tjerë të shtetit tonë", është shprehur Tërnavë.

Ndërsa ministri i FSK-së, Rrustem Berisha, ka falënderuar myftiun Tërnavë për vizitën, duke thënë se kjo vizitë është shumë domethënëse për FSK-në dhe do t'i shërbejë zhvillimit dhe ecjes përpara të proceseve shtetformuese. Në këtë kontekst, Berisha ka thënë se BIK-u është shumë i rëndësishëm për paqen dhe sigurinë në Kosovë. Ministri Berisha ka theksuar se ushtria e Kosovës do të jetë forcë paqësore që do t'u dalë në ndihmë të gjithë qytetarëve që jetojnë në Kosovë.

Qalaj takohet me drejtorët e policive të Shqipërisë dhe Maqedonisë

PRISHTINË, 26 DHJETOR (ER) - Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Rashit Qalaj, ka pritur të mërkurën në takim zyrtar drejtorët e policive të Shqipërisë dhe të Maqedonisë. Gjatë këtij takimi të përbashkët është biseduar për tema me interes të përbashkët të të tri agjencive policore, me theks të veçantë ngritja dhe avancimi i mëtejme i bashkëpunimit ndërinstucional, i cili do të ndikojë në ngritjen e sigurisë së

përgjithshme të të tri vendet dhe më gjerë. Qëllimi i bashkëpunimit dhe bashkërendimit të aktiviteteve policore do të ndikojë në mënyrë pozitive edhe për parandalimin e krimit të organizuar dhe atij trans-kufitar. Drejtori i Policisë së Kosovës, Rashit Qalaj, ka falënderuar dy drejtorët e policive, Ardi Velu dhe Sasho Tashevski, për vizitat e tyre të cilat do të shërbejnë për ta forcuar bashkëpunimin reciprok.



Rama: FSK-ja po ndërtohet mbi bazën e standardeve të NATO-s

Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), gjenerallejtënant Rrahman Rama, në një ligjëratë me studentët e Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini", me temën "Të arriturat e përgjithshme të FSK-së, transformimi si dhe e ardhmja e FSK-së", ka theksuar se FSK-ja po ndërtohet mbi bazën e standardeve të NATO-s

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

MITROVICË, 26 DHJETOR - Në Universitetin e Mitrovicës "Isa Boletini", nën organizim të dekanatit të Fakultetit Juridik, të mërkurën komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), gjenerallejtënant Rrahman Rama, para studentëve dhe stafit akademik, përfshirë të gjitha njësitë akademike, ka mbajtur një ligjëratë me temën "Të arriturat e përgjithshme të FSK-së, transformimi si dhe e ardhmja e FSK-së". Komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, ka përshëndetur studentët dhe stafin akademik, duke i uruar për aprovimin e tri ligjeve bazë për transformimin e FSK-së dhe Ministrinë e Mbrojtjes, me ç'rast ka falënderuar



angazhimin e ushtarëve dhe oficerëve të FSK-së, partnerët strategjikë, veçanërisht ShBA-në, po ashtu me theks të veçantë ata që kontribuan më së shumti për të ardhur kjo ditë: dëshmorët e rënë, familjet e dëshmorëve dhe luftëtarët e UÇK-së.

Duke falënderuar për kontributin e të gjithë aktorëve relevantë dhe parlamentarët për aprovimin e tri ligjeve, ai ka theksuar se qëllimi dhe synimi i Kosovës është ta ndërtojë një forcë që është në shërbim të të

gjithë qytetarëve. "Synimi ynë është që FSK-ja me mision të ri, në të ardhmen të jetë forcë paqeruajtëse", ka thënë gjeneral Rama, duke shtuar se nuk është qëllimi për ta rrezikuar dikë. Ai ka thënë se mbi bazën e këtij parimi Kosova në dy vjetët e fundit ka pasur angazhim të madh njoftues në kryeqytet më të mëdha evropiane. Sipas tij, qëllimi dhe synimi ishte njoftimi për së afërmi me procesin e transformimit të FSK-së. "Objektiv ynë është të jemi pjesë e strukturave të NATO-s

dhe jemi duke e ndërtuar FSK-në mbi bazën e standardeve të NATO-s", ka deklaruar Rama. Duke folur për shkollimin, trajnimet e pjesëtarëve të FSK-së, gjeneral Rama ka pohuar se djemtë dhe vajzat e FSK-së, kudo që kanë marrë pjesë, kanë qenë më të mirët, duke numëruar shtetet si: ShBA-në, Gjermaninë, Mbretërinë e Bashkuar, Maqedoninë, Kroacinë, Turqinë, Shqipërinë etj. "Këto rezultate janë arritur vetëm falë përkushtimit, disiplinës dhe punës këmbën-

gulëse. Ne do të vazhdojmë bashkëpunimin me NATO-n, ne kemi një ekip këshillues në FSK, me të cilin bashkëpunojmë ngushtë dhe çdo gjë e bëjmë mbi bazën e standardeve të NATO-s", është shprehur komandanti i FSK-së. Ai ka shtuar se me NATO-n/KFOR-in marrin pjesë në ushtrime të përbashkëta të cilat mbahen nga KFOR-i ose nga FSK-ja. "Ne jemi shumë mirënjohës për ndihmën e dhënë nga NATO dhe KFOR-i", ka thënë Rama.

Thaçi u jep 'Medalje Presidenciale' oficerëve të parë të UÇK-së



PRISHTINË, 26 DHJETOR (ER) - Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, u ka ndarë 'Medaljen Presidenciale' të 10-vjetorit të pavarësisë disa prej oficerëve të parë të UÇK-së. Ai përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook" ka shkruar se Kosova e kishte krijuar Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës para se ta shpallte pavarësinë e saj. "Një dekadë pas pavarësisë, në këtë fundvit kur unanimisht në

Kuvend u votua krijimi i Ushtrisë së Republikës së Kosovës, me 'Medaljen Presidenciale' të 10 Vjetorit të Pavarësisë i dekorova disa prej oficerëve të parë të UÇK-së. Këtë medalje sot e ndava për Kadri Kastratin, Binak Gashin, Mahir Hasanin, Mensur Kasumin, Hysni Ahmetin dhe dëshmorin Agim Qela. Ushtria e Kosovës është meritë e të gjithë qytetarëve tanë", ka shkruar Thaçi.

Rashiqi: Beogradi po i përdor serbët e Kosovës si instrument

PRISHTINË, 26 DHJETOR - Zëri i serbëve të Kosovës është shuar dhe të gjitha mekanizmat janë vënë në shërbim të një grupi politik, Listës Serbe, që nuk po bën asgjë pozitive për pop-

ullin serb. Kështu ka thënë në një intervistë për "Radion Evropa e Lirë", ish-ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale në mandatin e kaluar qeveritar, Nenad Rashiq,

kryetar i Partisë Demokratike Progresiste. Ai ka theksuar se Beogradi zyrtar po i përdor serbët e Kosovës si instrument për pozicionim para dialogut, por edhe për


arsye të tjera. Pavarësisht se të dyja palët janë në kurse të ashpra, Rashiqi pret që së shpejti do të nisë faza përfundimtare e dialogut Kosovë - Serbi.



Nënshkruhet marrëveshja për rregullimin e parkut të qytetit në Malishevë

MALISHEVË, 26 DHJETOR (ER) - Komuna e Malishevës, "PREDA Plus dhe ASB", si dhe shoqata "Fatjona" kanë nënshkruar një marrëveshje për financimin e përbashkët të projektit për rregullimin e parkut të qytetit të kësaj komune. Ky projekt financohet nga projekti "Stabiliteti socio-ekonomik i komuniteteve pakicë dhe shumicë në Kosovë, e që është iniciativë e financuar nga Engagement Global në emër të Ministrisë Federale Gjermane për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik-BMZ, që në Kosovë është duke u zbatuar nga PREDA Plus Kosovë dhe Arbeiter Samariter Bund (ASB).

Kjo marrëveshje është nënshkruar nga nënkryetari i Komunës së Malishevës, Hajdin Berisha, drejtori i projektit nga PREDA Plus, Valentin Hoxha dhe nga Fatime Limaj, përfaqësuese e Shoqatës "Fatjona". Përmes kësaj kontrate të nënshkruar do të përkrahet iniciativa për "Rregullimin e parkut të qytetit" në Malishevë, ku shuma e planifikuar e këtij projekti është 25 mijë euro. Në këtë projekt Komuna e Malishevës do të participojë me 15 mijë euro, kurse përmes projektit të PREDA Plus dhe ASB projekti do të përkrahet me 10 mijë euro.



Bahtiri e informon komandantin e KFOR-it për gjendjen e sigurisë në Mitrovicë

MITROVICË, 26 DHJETOR (ER) - Kryetari i Komunës së Mitrovicës, Agim Bahtiri, ka pritur në takim komandantin e ri të KFOR-it, gjeneralmajor Lorenzo D'Addario, me të cilin ka biseduar për zhvillimet aktuale dhe gjendjen e sigurisë në këtë komunë. Pasi e ka vlerësuar lart bashkëpunimin e Komunës së Mitrovicës me pjesëtarët e KFOR-it, Bahtiri e ka njoftuar komandantin D'Addario mbi gjendjen aktuale politike e të sigurisë në këtë komunë, për të cilën ka thënë se është e qetë dhe pa probleme. "Në komunën tonë

janë bërë hapa të mëdhenj në stabilizimin e plotë të gjendjes së përgjithshme. Për këtë gjë u jam mirënjohës KFOR-it, Policisë së Kosovës, karabinierëve dhe të gjithë ata që kontribuuan për ruajtjen e paqes për qytetin tonë. Në këtë drejtim qenësor ka ndikuar edhe angazhimi dhe përkushtimi i vet qytetarëve, të të gjitha përkatësive etnike, për të pasur një situatë të qetë dhe stabile", ka thënë Bahtiri.

Ndërsa komandanti i ri i KFOR-it, gjeneralmajor Lorenzo D'Addario, është shprehur i kënaqur me të arriturat e

Mitrovicës, duke shtuar se bashkëpunimi i mirë i deritanishëm ndërmjet kësaj komune dhe KFOR-it do të shtohet dhe të pasurohet edhe më shumë, me qëllimin e vetëm të realizimit të kërkesave të qytetarëve për të jetuar në paqe dhe për një jetë pa brenga. Po ashtu, komandanti D'Addario ka kërkuar nga kryetari Bahtiri të mbesin vazhdimisht në kontakt dhe të jetë i informuar lidhur me të gjitha ngjarjet në Komunën e Mitrovicës, në mënyrë që bashkërisht të kontribuojnë në ruajtjen e paqes dhe sigurisë së qytetit.



Ismet Temaj nisi detyrën e ushtruesit të detyrës së rektorit në UPZ

PRIZREN, 26 DHJETOR (ER) - Prof. asoc. dr. Ismet Temaj të mërkurën ka nisur detyrën e ushtruesit të detyrës së rektorit në Universitetin "Ukshin Hoti" në Prizren. Që në mëngjes kishin dalë disa studentë për ta përshëndetur marrjen e detyrës, të cilët e pritën me duartrokitje. Ndërkohë një grup tjetër prej studentëve erdhën për ta uruar për detyrën dhe i

sollën një buqetë me lule. Kurse në mëngjes një tjetër grup i vogël me studentë kishin bllokuar dyert e kompleksit me dry dhe zinxhirë dhe kanë vendosur pankarta në shenjë proteste për zhvillimet e fundit në universitet.

Ushtruesi i detyrës së rektorit në Universitetin "Ukshin Hoti", Ismet Temaj, u shpreh falënderues dhe mirënjohës për

urimet e studentëve, ndërsa ka theksuar se janë të mirëpritur protestat për çështje të studentëve mirëpo, sipas tij, është e papranueshme dhe nuk është mesazh i mirë vendosja e drynit dhe zinxhirëve nga një grup i vogël me studentë. Ai ka thënë se do të punojë për zhvillimin e këtij universiteti në çdo aspekt dhe do të bashkëpunojë me të gjithë në bazë të ligjit.

Jashari shpërndan dhurata për fëmijët me nevoja të veçanta

Skenderaj, 26 dhjetor (ER) - Kryetari i Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, së bashku me bashkatdhetarin Ilir Sinani dhe reperin Gold AG, kanë shpërndarë dhurata për fëmijët me nevoja të veçanta. Jashari nëpërmjet llogarisë së vet në "Facebook" ka thënë se ndihet i nderuar me rastin e shpërndarjes së dhuratave në prag të festës për fëmijët me nevoja të veçanta. "Ndjenjë e mirë të shpërndajmë dhurata

në prag të festës, për fëmijët me nevoja të veçanta. Së bashku me bashkatdhetarin Ilir Sinani, pronar i firmës 'Sinani GMBH & CO. KG' në Gjermani dhe reperin e njohur Gold AG, kemi gëzuar me dhurata fëmijët me nevoja të veçanta në Skenderaj. Falënderoj bashkatdhetarin Ilir Sinani dhe Gold AG që financuan dhuratat për këta fëmijë si dhe ndihmuan një familje me gjëra ushqimore në Komunën e Skenderajt", ka shkruar Jashari.



Haradinaj kërkon të ulët çmimi i naftës

PRISHTINË, 26 DHJETOR (ER) - Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka reaguar ndaj rritjes së çmimit të naftës në Kosovë. Ai ka thënë se ky është dëmtim financiar i padrejtë i qytetarëve të Republikës së Kosovës dhe është i patolerueshëm. "Dëmtimi i padrejtë financiar i qytetarëve të Republikës së Kosovës është i patolerueshëm. Kjo po ndodh nga kompanitë që importojnë dhe shesin naftë në Kosovë. Çmimi i naftës në tregun botëror dhe rajonal është më i ulët aktualisht, derisa në tregun e Kosovës operatorët nuk kanë reflektuar. U bëj thirrje

Autoritetit Kosovar të Konkurrencës, Ministrisë së Tregtisë, Shoqatës së Naftëtarëve dhe të gjithë mekanizmave të tjerë që t'i ndërmarrin hapat e nevojshëm për ta ndryshuar këtë praktikë të keqe që dëmton qytetarët tanë", ka thënë Haradinaj. Ai ka shtuar se çmimi i naftës duhet të jetë konform çmimit të tregut. "Është e kuptueshme që tregu i lirë funksionon i pavarur, por kjo nuk nënkupton, në asnjë formë, dëmtimin e qëllimshëm të buxhetit të familjeve kosovare", ka deklaruar kryeministri Haradinaj.



Arbitrazhi të përdoret për zgjidhjet e kontesteve në prokurimin publik



EPOKA E RE **A. MAVRAJ**

PRISHTINË, 26 DHJETOR - Arbitrazhi si mjet për zgjidhjen e kontesteve përkrahet fuqishëm edhe nga ana e shoqërisë civile, sidomos për zgjidhjen e kontesteve që dalin nga prokurimi publik, për faktin se hulumtimet e shumta të kryera nga ana e organizatave të shoqërisë civile theksojnë se nga mungesa e efikasitetit të gjykatës në zgjidhjen e rasteve të tilla, qoftë për shkak të ngarkesës me lëndë apo mungesës së ekspertizës adekuate në fushën e prokurimit publik. Kështu u tha të mërkurën në tryezën e organizuar nga Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë për perspektivën e shoqërisë civile mbi arbitrazhin në prokurimin publik. Tea Blakaj, sekretare e përgjithshme e Qendrës së Arbitrazhit në Odën Amerikane, ka thënë se zgjidhja e kontesteve nga fusha e prokurimit publik përmes arbitrit të pavarur, ekspertit në fushën e prokurimit publik, shihet si alternativë e mirëseardhur, por edhe e domosdoshme me qëllim të arritjes së efikasitetit të kërkuar në mbarëvajtjen e procedurave të prokurimit publik. Arian Zeka, drejtor ekzekutiv i Odës Amerikane, vuri theksin mbi angazhimin e Odës

Amerikane në promovimin e arbitrazhit si një metodë efikase dhe të shpejtë e cila garanton për zgjidhjen e drejtë të kontesteve. Zeka ka theksuar se Oda Amerikane që nga viti 2013 përmes Këshillit Kombëtar të Zhvillimit Ekonomik ka ngritur nevojën për ndryshimplotësimin e Ligjit të Prokurimit Publik në mënyrë që të promovohet edhe promovimi i klauzolave të arbitrazhit në kontratat e prokurimit publik. Lekë Batalli nga Grupi për Studime Juridike dhe Politike, duke u pajtuar me avantazhet e arbitrazhit dhe nevojën për përdorim më të shpeshtë të kësaj metode alternative për zgjidhjen e kontesteve, vuri theksin mbi sundimin e dobët të ligjit në përgjithësi dhe joefikasitetin e gjykatave dhe prokurorive për t'ua dhënë një epilog të duhur çështjeve ekonomike. Batalli ka theksuar se indeksi i performancës të sektorit të drejtësisë, studim ky i cili bëhet nga GLPS, tregon se vetëm 73 për qind e qytetarëve kanë besim në gjykata dhe prokurori. Duke konsideruar se përfshirja e klauzolave të arbitrazhit në kontrata të prokurimit publik është e nevojshme dhe një aspekt i duhur i veprimit, Batalli theksoi të ndërmerren masat të cilat sigurojnë një zbatim të mirëfilltë të këtyre klauzolave. Arton Demhasaj nga organizata "Çohu!" njoftoi të pranishmit

mbi zhvillimet e fundit në kodin penal ku është arritur për ndryshimplotësimin e tij, duke paraparë për dispozita ndëshkuese më të larta për shkelësit gjatë procedurave të prokurimit publik, përfshirë këtu edhe përjashtimin nga e

drejta për të konkurruar në procedura të ardhshme të tenderimit. Ndërlidhur me efikasitetin e strukturave të drejtësisë, Demhasaj ka theksuar se vërehet mungesa e profesionalizmit dhe profileve të duhura të cilat do të rezultonin në një

rritje të efikasitetit të gjykatave dhe prokurorive. Më tutje, bizneset e pranishme diskutuan mbi njohjen më të thellë të avantazheve të arbitrazhit si dhe u ritheksua nevoja për përmirësimin e sundimit të ligjit në vend.



Ministri Endrit Shala vizitoi kompaninë 'M-Technologie'

PRISHTINË, 26 DHJETOR - Ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Endrit Shala, ka vizituar kompaninë "M-Technologie", që është një nga eksportuesit më të mëdhenj të Kosovës. Ministri Shala ka ndarë mirënjohje për këtë kompani për

shkak të ndikimit të rritjen e punësimit dhe zhvillimin ekonomik të vendit. Ministri bëri të ditur se siguron qytetarët e Kosovës dhe drejtuesit e kësaj kompanie që Qeveria e Kosovës, Ministria e Tregtisë, do të jetë e

përkushtuar për rritje të prodhimit vendor. Ndërsa drejtori i kompanisë "M-Technologie", Rrustem Pacolli, ka falënderuar ministrin për vizitën dhe përkrahjen, duke besuar në mbështetjen e MTI-së në kërkesat e tyre që i kanë.

Dialogu në kthetrat e formatit

Pse "pozitë-pozitë" e jo "çlirimtarë-paqësorë"



Shkruan: Blerim MURIQI

Muaji i fundit karakterizohet me pragmatizmin e qeverisë karshi detyrave kushtetuese. Taksa, dhe jo vetëm ajo, u bë "hiti" dhe "fati" i marrëdhënieve me Serbinë. Të shumtë thonë se këto duheshin bërë shumë më herët, bile e zhvendosin në qeveritë e mëparshme. Rrethanat dhe lider-shipi i drejtuesve të pozitës sollën vendimet e qartësimi: Ushtrinë, taksat, paraburgimin e të dyshuarve për vrasjen e politikanit serb Oliver Ivanoviç. Tashmë Serbia mund ta shohë më qartë pozicionin e saj, jopran-inë e saj në Kosovë as si e drejtë e as si mundësi, vetëm si një shtet fqinj. Politika serbe e ka ditur këtë që në krye të herës. E keqja e saj është se ajo ka krijuar në gjithë këto vite mjegullën për optikën mashtruese të popullatës me etni serbe.

Dialogu tashmë ka një rrugë krejt të veçantë! Ai ka hyrë në një fazë të re. Të gjithëve po na ngutet dhe amerikanët janë këtu! Kaq do të mjaftonte ta kuptonim në ç'pikë jemi!

A po e trajtojmë e kuptojmë të gjithë këtë në peshën reale?

Parë nga pozitë që mbajtën fillimisht LDK-ja dhe LV-ja nuk mund e as duhet të ndihemi të qetë. Kjo na bën ta shohim me kujdes sforcimin e qeverisë, pres-

identit, grupit negociator etj. Tash e në këtë moment duket i pashije dilitantizmi që provon të bëjë protagonizmin e opozitës së mbetur të papërfshirë në trupën negociuese.

Barka e LDK-së prej kohësh ka mbetur pa vela e pa motor dhe ashtu në mjegullën e saj po tundohet mes bregut e thellësive të ujërave. Kryetari i saj, z. Mustafa, po jep e po merr me opinionin. Ai sikur po klith ta presin edhe pak! Nuk është vetëm klithje!

LDK-ja duket se e ka kuptuar gabimin që prodhon mbetja jashtë procesit! Ajo ka hedhur spirancat e ndërrimit të formatit për "Trupën negociuese". Nga sa kuptojmë nga paraqitjet e z. Mustafa, ai tashmë po aspiron hiq më pak sesa bashkëdrejtimin. Ai thotë: marrëveshja nuk mund të bëhet pa pjesëmarrjen e përfaqësimit të politikës paqësore dhe të luftës çlirimtare. Nuk është, pra, vetëm klithje. Z. Mustafa po provon diversionin institucional! Pra, z. Mustafa po tenton që përbërjen e trupës negociatore pozitë-opozitë ta provokojë me formacionet e së shkuarës "çlirimtarë" dhe "paqësorë".

Nuk besoj se është kjo gjetja e duhur për ta rikthyer peshën specifike në skenën tonë vendimmarrëse. Mungesa e lideshipit në LDK e ka bërë atë të lëngojë dhe të mos performojë politikëbërje. Vegjetime të tilla janë karakteristika për partitë të cilat e humbin shtyllën e tyre qoftë atë programore a lideriste. Tashmë LDK-ja mund t'i bashkohet trupës negociatore si një nga subjektet opozitare e kurrësi si gjysma paqësore që plotëson e pariton gjysmën çlirimtare. Ish-

gatishmëria e Fatmir Limajt, drejtuesit real, tashmë bashkëdrejtues formal, të trupës negociuese për t'i dhënë edhe krejt drejtimin z. Mustafa, është një çështje e tejkaluar dhe kjo e bën të pakthyeshëm procesin. Edhe z. Konjufca, në një media elektronike, na dha të kuptojmë se LV-ja nga brenda ka lëvizur, por nuk po di ta gjejë çelësin e pranueshmërisë.

Gjithmonë te Vetëvendosja kemi pasur kundërshtinë si mbijetesë dhe paralajmëruese për gatishmëri e pranueshmëri, sikur edhe u pa në një video të cilën e publikoi deputeti Frashër Krasniqi, e ku shihej z. Kurti të kishte pranueshmëri edhe koalicionesh me PDK-në a këdo tjetër të skenës politike.

Kjo mosekzistencë e vijave të kuqe është e shëndetshme për proceset që po kalojmë si veçanti e për jetën tonë politike të brendshme në përgjithësi.

LV-ja, sikur është në zakonin e saj, mund të vonohet për proceset që po kalojmë e do të kalojmë në të ardhmen e afërt, sepse ajo akoma nuk ka mësuar se si ta nxjerrë në skenë veten e saj reale. Të tilla sjellje ajo i merr akoma si shprehje dobësie dhe jo sikur duhet të jetë në të vërtetë shkathtësi, vlerë e shtuar në rrugëtimin e pjekjes politike. Rreth dy javë na ndajnë nga ajo që po shihet edhe nga opinionin ndërkombëtar si fillimi i fundit për sa i përket një marrëveshjeje gjithëpërfshirëse me Serbinë. Kur kemi të bëjmë me bisedimet është e vështirë t'u caktojmë limite, por faktorët që kontribuojnë për paqen mes shteteve tona sikur kanë punë më të mëdha. Ballkani di të prodhojë paqën-

drueshmëri dhe kjo e bën më kërkuese bashkësinë ndërkombëtare. Kjo ngutje për dikë e ky pragmatizëm për euro-perëndimorët do të duhej të ndikonte me peshën e tyre dhe papërsëritshmërinë e mundësisë edhe te skeptikët e skajshëm vendorë e lëre më te partitë të cilat në zgjedhjet që lamë pas ishin krejt afër t'i merrnin përgjegjësitë qeverisë. Ne po hyjmë në vitin e sfidave të mëdha. Dialogu për marrëveshjen gjithëpërfshirëse me Serbinë dhe Gjykata Speciale janë jo vetëm dy temat e mëdha, por edhe dy sfidat, po ashtu shumë të mëdha. Ka shumë njerëz mes nesh që i gëzohen kësaj të dytës, gjykatës, ku shohin mundësinë e mbetjes si të paprekur dhe pushtetarë të së nesërme. Letra e tillë do të bëhej vetë fataliteti i një ploje morale të shoqërisë.

Është thënë e stërrthënë si rrezik më vete presidenti i vendit. Ai mbetet akoma i paparashikueshmi që bartë shumë rreziqe. Ai vjen edhe sot e kësaj dite me shumë të panjohura për dialogun e deritanishëm të fshehtë. Ata që duan ta ndalin presidentin duhet të dinë se ai nuk ndalet duke qëndruar mënjatë e në tekanjozitet, por duke u bërë pjesë në rrugën e dialogut dhe zhvillimeve, prej ku aksesit është i plotë si në njohje, po ashtu edhe për veprim.

Se duhet të shpejtohet me bashkimin në proces dhe të kontribuohet që ai të shkojë drejt fundit na duhet të kuptojmë secili që sot njeh zhvillimet. Bartësit e institucioneve të vendit kanë kapitalin e mjaftueshëm për ta drejtuar procesin. Bashkimi rreth tyre do të na ndihmonte për të ardhmen tonë. Duke qëndruar jashtë procesit

ne i rezervojmë vendit një të ardhme jo të mirë, të ndarë në të mirë e të këqij etj!

Dhe një e fundit në fokus të sipërthënës: Gjykata Speciale po i sillet vendit si një dinozaur i qelbur. Ajo, sipas atyre që thuhet në mediat tona, do të godasë një numër jo të vogël. Skena jonë politike do të pësojë një tronditje si fillim, sepse Gjykata do të godasë dy drejtimesh. Ajo do të ketë të akuzuar dhe akuzues, të hetuar e dëshmitarë. Këta të dytët një pjesë do të jenë, po ashtu sikur po thuhet, koluareve, qytetarë tanë të Kosovës. E keqja mund të jetë po doli të ketë pasur një hile të organizuar dhe me baza partiake. Kjo do ta rëndojë edhe më shumë besueshmërinë mes nesh si shoqëri, veçanërisht po të ribëhet ajo ndarja që po provon ta jetësoj z. Mustafa: "çlirimtarë" e "paqësorë".

Hisja në libërjen e vendit u takon të rënëve dhe heronjve të gjallë. Andaj, përpjekja e z. Mustafa, që ta bëjë palë LDK-në nëpër procese në formatin "çlirimtarë" dhe "paqësorë" është një veprim i mjerë. Është koha e këndelljeve të mëdha. Formatit pozitë-opozitë-shoqëri civile është formati më i shëndetshëm që kanë prodhuar shoqëritë e organizuara dhe që na shkon për shtati në këtë fazë historie që po kalojmë tash e sa dekada. Kjo çështje është goxha e thellë dhe shoqëria jonë nuk ka pse ngatërrohet me të në këto çaste kaq të brishta! Historianët do ta thonë të vërtetën përmes argumenteve historike. Opozita e mbetur jashtë procesit ka shumë arsye pse duhet të bëhet pjesë e zhvillimeve dhe e marrjes së përgjegjësisë! Të shpresojmë!

Hoxha viziton familjet katolike në darkën e Krishtlindjes

GJAKOVË, 26 DHJETOR - Familjen Halilaj nga Bardhaniqi i Gjakovës e ka gëzuar vizita e imamit të fshatit Jabllanicë e Madhe nga Peja, Sadri Zekaj, për darkën e Krishtlindjes. Fotografia e hoxhës, i ulur afër një kryqi të varur në mur gjatë darkës së Krishtlindjes, është shpërndarë shumë shpejt në mediat sociale.

Imami Zekaj ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se kjo nuk është vizita e tij e parë që i bën një familjeje të besimit tjetër pasi disa vjet me radhë shkon në darkat e Krishtlindjes te familje të ndryshme të besimit katolik që jetojnë në rajonin e Pejës, Klinës dhe Gjakovës. "Mua që disa vjet më marrin familje të mëdha, familje që kanë dëshirë. Sivjet është lajmëruar familja Halilaj duke më thënë 'a mund të vish dhe ta gëzosh familjen tonë' dhe unë i thashë me

gjithë dëshirë. Kam shkuar me vullnet, kam pasur një pritje të jashtëzakonshme. Kemi kaluar shumë mirë", ka thënë Zekaj, duke shtuar se këtë vizitë e ka bërë me dëshirën më të madhe. "Unë rregullisht shkoj dhe këtë e kam bërë me dëshirë të madhe, që t'u tregoj edhe disa të tjerëve që ne dhe ata (katolikët) jemi vëllezër, vetëm besimi na dallon. Ne jemi shqiptarë, kemi gjuhë të përbashkët, një gjak, një flamur, një shtet, të gjitha i kemi tonat. Për këto arsye shkojmë vullnetarisht në shumë vende", ka thënë Zekaj.

Zekaj ka shtuar se gjatë luftës në Kosovë, në fshatin e tij Jabllanicë e Madhe, ai dhe familja e tij kanë pranuar të strehojnë shumë familje katolike në shtëpinë e tij, me të cilët sot e kësaj dite takohen për festën e Bajramit dhe atë të Krishtlindjes.



"Fshati Jabllanicë e Madhe gjatë luftës ka qenë korridori kryesor që ka ndihmuar shqiptarët të largohen nga represioni i atëhershëm serb,

prandaj shumë njerëz kanë kaluar andej. Prandaj kam pasur edhe familje krishtere që kanë ardhur aty dhe i kam pranuar, kanë fjetur, i

kam përcjellë edhe për Rozhajë. Tash edhe ata shpesh vijnë për Bajram dhe kontaktojmë shpesh", ka deklaruar Zekaj.

Narkoza e vizave - mit apo realitet (6)



Shkruan: Agron HOTI

Pse të paguajmë çmim?!

Në qoftë se kriza e refugjatëve sirianë ka dridhur BE-në në tërësinë e saj, ka rritur dhe thelluar ndasitë mes shteteve anëtare të BE-së, ka rritur populizmin nacionalist gjithandej BE-së, ka pjell Brexitin dhe me një fjalë ka shkundur tërë BE-në, pse duhet që Kosova të izolohet duke paguar çmimin e këtyre problemeve gërryese brenda BE-së?! Në qoftë se korrupsioni, krimi i organizuar, ekonomia joformale janë evidente edhe në shtetet më të fuqishme të botës, përfshirë edhe vende të BE-së, atëherë s'mund të pritet as nga Kosova që të jetë immune duke pasur parasysh dallimin në zhvillim të kapaciteteve me shtete mbi 300-vjeçare.

BE asnjëherë se mori parasysh këtë fakt, dhe ndonëse ishim një vend me të kaluar shumë të dhimbshme, ajo e zvarriti këtë proces deri në pafundësi. Pra, edhe pse Kosova doli nga një luftë gjenocidale që sistematikisht ushtronte Serbia mbi popullsinë e pambrojtur shqiptare, të cilën tërë NATO u desh të zgjohej në këmbë për ta ndaluar, BE na dyfishoi kriteret nga 42 sa kishin vendet e rajonit në 95. Nuk duhet harruar se pikërisht në kohën kur BE është duke vluar nga problemet e brendshme si p.sh. i) borxhi publik në rritje në pothuaj tërë vendet e

BE-së, ii) humbjet elektorale të partive tradicionale që historikisht mbështetën projektin Evropian dhe fuqizimi i atyre që synojnë shkatërrimin e këtij projekti, iii) rënien e nivelit të demokracisë nëpër shtete të ndryshme të BE-së sidomos në pjesën lindore dhe jugore të saj; iv) rritja e disparitetit në zhvillim ekonomik mes jugut dhe veriut të BE-së, iv) rënien e lirë demografike nëpër tërë BE-në dhe nevojën për fuqi të re punëtorë dhe jogatishmërinë e politikanëve dhe Shteteve Anëtare të BE-së për të përgatitur vendet e tyre për këtë trend në ardhje, Kosova në anën tjetër në vitin 2016 e 2017 shënoi progres në Raportin e Transparency International duke u ngritur në 10 vende më lartë dhe natyrisht plotësoi edhe kriteret për liberalizim të vizave. Sigurisht që kjo nuk është perfekte, por jep indikacion pozitiv.

Kush e zbuloi korrupsionin?!

Askush nuk e mohon korrupsionin endemik dhe krimin e organizuar në Kosovë dhe rajon, ashtu siç nuk mund ta mohojë korrupsionin brenda BE-së dhe Shteteve Anëtare të saj, ku investitorë evropianë të mbështetur fort nga qeveritë e tyre investojnë sa të mundën nëpër shtete me popullsi të mëdha (si Kina, India, Brazili, Indonezia, Pakistani, Bangladeshi, Vietnami, etj.), të cilat vlojnë nga korrupsioni dhe krimi i organizuar. Mjafton të lexojmë sot gazetatat e njohura botërore dhe të kuptojmë se ç'po ndodh nëpër botë, përfshirë BE-në.

Gazetat si "Economist", të cilat qytetarët e Kosovës sot për fat të

mirë kanë mundësi t'i lexojnë, të mekin për nivelet korruptive brenda BE-së dhe nga nivelet korruptive që kompanitë e BE-së demonstrojnë nëpër vendet ku investojnë, sidomos nëpër vendet me popullsi të mëdha, ku syri i medias nuk arrin të kap detajet dhe ta kuptojë kompleksitetin dhe allazhvershet e korporatave të ndryshme.

Pastaj, është sekret publik se qindra miliarda euro keqpërdoren nga vet institucionet e BE-së dhe Shtetet Anëtare të saj, këto të fundit keqpërdorin fonde të zhvillimit rajonal. Mjafton të lexosh raportet e Gjykatës së Auditorëve të BE-së si e Raporte të ndryshme ndërkombëtare dhe të shohësh nivelin korruptiv gjatë implementimit të fondeve të BE-së gjithandej globit.

Pra, nëse Kosova ka korrupsion, kjo nuk është më ndryshe as në hapësirat e BE-së. Sigurisht që kjo nuk është arsyetim për vizionin e Kosovës, sepse ne duhet të vazhdojmë të merremi me këtë problematikë të rëndë, por të njëjtën sfidë e ka pothuaj çdo shtet në botë.

Dhe në qoftë se shtete që ekzistojnë që mbi 300 vjet, nuk kanë arritur ta zhdukin tërësisht korrupsionin, krimin e organizuar dhe ekonominë joformale, e as që pritet ta zhdukin ndonjëherë, pasi vetë struktura e shtetit është aq komplekse sa zbrazëti-rat në qeverisje gjithmonë do të jenë aktuale, atëherë si paska mundësi që Kosova ta bëjë një gjë të tillë? Sigurisht që kjo nuk e arsyeton dhe s'duhet të kuptohet si arsyetim i gjendjes jo të mirë në Kosovë, por një shtet që ka vetëm 10 vjet s'mund të arrijë qeverisje ideale.

A ka korrupsion në BE?

A nuk ishte korrupsion nga

evropianët transferimet e miliardave euro në Panama Papers, a nuk janë korrupsion miliardat që transferohen nga një shtet në tjetrin brenda vendeve të BE-së për t'iu ikur tatimeve, a nuk janë korrupsion lobingjet e ndryshme brenda BE-së që shtyjnë përpara agjenda të ndryshme në interes të grupeve të ndryshme të interesit, a nuk janë korrupsion shpëlarjet e mbi 100 miliardë euro në vit (sipas "Economist") vetëm në Londër! Thuhet që institucionet përgjegjëse në Angli nuk po kanë kapacitete e resurse të mjaftueshme për të luftuar shpëlarjen enorme të parave në këtë shtet.

A nuk janë korrupsion afëra të panumërta brenda për brenda vendeve të BE-së, a nuk janë korrupsion deponimi i miliarda eurove të kriminelëve më të mëdhenj që ka njohur bota prej pas Luftës së Dytë Botërore e deri më sot nëpër vende të hapësirës së Schengenit, a nuk janë korrupsion aferat multimiliardëshe të fabrikave të veturave që po manipulojnë shifrat e emetimit të dyoksidit të karbonit, industri kjo e mbështetur fuqishëm nga politika e vendeve të ndryshme?!

A nuk është korrupsion tregtia me këlyshë të qenve anë e përtej BE-së (me qindra miliona euro), tregtia me drogë e armë në vlerë miliarda eurosh, a nuk janë korrupsion lidhjet e shefave të shteteve/kryeministrave të vendeve të BE-së, të cilët menjëherë pas përfundimit të mandateve politike, kalojnë në projekte euro-multimiliardëshe, kontratat e të cilave i kishin negociuar sa ishin në pushtet, a nuk janë korrupsion lidhjet e dyshimta të politikanëve të kalibrit të lartë të Shteteve të BE-së me firma të ndryshme kineze, ruse, etj., duke dëmtuar kështu

seriozisht ekonominë e BE-së?! E tash kur afëra korruptive ka për çdo ditë nëpër vende të ndryshme të BE-së, cilët janë ata politikanë që po dënohen dhe po futen në burg?! As kjo nuk duhet të arsyetojë kontekstin e Kosovës, por patjetër që tregon se as edhe vendet më të fuqishme në Evropë nuk janë immune ndaj korrupsionit dhe krimit të organizuar. Madje ka vende të BE-së, të cilat të sfiduar seriozisht nga korrupsioni dhe krimi i organizuar kanë themeluar Prokurori Speciale (struktura të reja) për të luftuar korrupsionin, Ndonëse rezultatet kanë qenë të kufizuara si çdokund tjetër në botë.

Pra, qëllimi i këtij artikulli nuk është relativizimi i një të keqeje siç padyshim është korrupsioni dhe krimi i organizuar, por vetëm krahasimi i gjendjes, e cila na tregon se keqpërdorimi i parasë publike fatkeqësisht është duke ndodhur në çdo cep të botës. Kjo është tejet e dhimbshme, por fatkeqësisht realitet, ndërkohë që institucioneve të Kosovës, do t'u duhen vite për të reduktuar këto dukuri të këqija, ashtu siç u kanë marrë dhe u marrin vite edhe vendeve më të fuqishme në glob, përfshirë BE-në.

Duhet të jemi të vetëdijshëm që luftimi i korrupsionit dhe krimin të organizuar është një proces, me të cilin institucionet e Kosovës do të merren një kohë të gjatë. Sa më shumë që do të zhvillohet vendi në aspektin ekonomik aq më i vogël do të jetë korrupsioni, këtë e ka treguar praktika, siç është shembulli me Korenë Jugore dhe pse zhdukja e plotë e tij ka rezultuar të jetë e pamundshme edhe në demokracitë më të zhvilluara në glob.

(Vijon)

Një rrugë në Suharekë merr emrin e dëshmorit Asllan Gashi

Kryeministri Haradinaj para të pranishmëve të shumtë ka thënë se Asllan Ukë Gashi sot po përjetësohet në një rrugë të vendit të vet, të Suharekës, po i shtohet plejadës së dëshmorëve, të cilët Suhareka i ka shumë.

SUHAREKË, 26 DHJETOR (ER) - Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka zhvilluar të mërkurën një vizitë pune në Komunën e Suharekës, ku bashkë me kryetarin e komunës, Bali Muharremaj, ka marrë pjesë në zbulimin e emërimit të rrugës me emrin e dëshmorit Asllan Gashi, i vrarë në vitet '80 në ish-armatën jugosllave. Kryeministri Haradinaj para të pranishmëve të shumtë ka thënë se Asllan Ukë Gashi sot po përjetëso-

het në një rrugë të vendit të vet, të Suharekës, po i shtohet plejadës së dëshmorëve, të cilët Suhareka i ka shumë. "Rruga për liri dhe atdhe-dashuri në Suharekë është e veçantë për shkak se flijimet janë të veçanta dhe të hershme", ka thënë kryeministri Haradinaj, duke përgëzuar komunën që po e përjetëson emrin e dëshmorit të atdheut Asllan Gashi në një rrugë.

Po ashtu, kryeministri Haradinaj ka theksuar se kjo është një ngjarje e

mirë edhe për familjarët, duke shprehur respektin për ta, për dhimbjen që e kanë mbajtur për tri dekada, duke shtuar se kjo është një dëshmi se sa e dhimbshme ka qenë rruga jonë për liri.

Kryetari i Komunës, Bali Muharremaj, ka thënë se liria dhe pavarësia për qytetarët e Kosovës ka filluar shumë herët, jo në vitet e '90, e as me luftën e fundit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, por menjëherë pas Luftës së Dytë Botërore.



Parashikoi fitoren e Trumpit, tani flet për limitim të presidencës

WASHINGTON, 26 DHJETOR - Historiani Allan Lichtman ishte ndër të paktët njerëz që parashikuan fitoren e Donald Trumpit në zgjedhjet e vitit 2016. Tani ai parashikon një "Impeachment" në vitin 2019. Lichtman, shkencëtar politik në American University në Washington, u bë një yll mediatik pas prognozave të tij se Trumpi do të triumfojë në zgjedhjet presidenciale.

Presidenti është mbështetur deri tani te Kongresi i kontrolluar nga republikanët, sepse ai i ka bllokuar procedurat për largimin e presidentit nga posti. Por me fitoren e shumicës nga demokratët, në nëntor të këtij viti, gjendja ka ndryshuar tërësisht. Demokratët kanë tani në Dhomën e Përfaqësuesve 30 mandate më shumë, ndërkohë që për nisjen e procedurave kundër Trumpit mjafton vetëm një votë më

shumë.

Tema "Impeachment" ka qenë në ShBA për një kohë shumë të gjatë një zonë gri, ndërsa tani mund të shndërrohet në realitet, mendon historiani. Ai arsyeton se nëse hetimi i drejtuar nga Robert Mueller sjell dëshmi të qëndrueshme kundër Trumpit, atëherë baza e demokratëve do ta kërkojë ngritjen e një aktakuze ndaj kreut të shtetit, ndaj raporti i Muellerit mund të përbëjë një rrezik të madh për të.



Temat kryesore të 2018-s në Kongresin amerikan

Debatet në Kongres gjatë vitit 2018 u dominuan nga shqetësimet në lidhje me privatësinë e të dhënave në internet, reformën e imigracionit dhe betejën për emërimin e kandidatit për në Gjykatën e Lartë, Brett Kavanaugh



WASHINGTON, 26 DHJETOR - 2018-a ishte një vit zgjedhor i rëndësishëm për zgjedhjet e Kongresit dhe republikanët e filluan vitin me synimin për t'i nxjerrë në pah shkurtime dhe taksave dhe rritjen e fortë ekonomike. Por, debatet në Kongres gjatë vitit 2018 u dominuan nga shqetësimet në lidhje me privatësinë e të dhënave në internet, reformën e imigracionit dhe betejën për emërimin e kandidatit për në Gjykatën e Lartë, Brett Kavanaugh, ishte momenti kulmor për lëvizjen MeToo në Kongres.

Akuzat e Ford për sulm seksual e vunë në pozita mbrojtëse gjykatësin federal Brett Kavanaugh, kandidatin e presidentit Trump për anëtar të Gjykatës së Lartë.

Me gjithë protestat dramatike,

Kavanaugh u konfirmua me një rezultat të ngushtë nga Senati i kontrolluar nga republikanët. Debatet e ashpra për emërimin e tij nxorën në pah ndarjet partiake dhe pothuajse bllokuan Uashingtonin. Republikanët dhe demokratët shkëmbyen akuza me njëri-tjetrin në luftën për miratimin e buxhetit. "A do ta mbyllin ata qeverinë për imigracionin e paligjshëm?", pyeste udhëheqësi i pakicës demokrate, senatori Chuck Schumer. Politika partiake u la mënjanë tri herë për t'u bërë nderime shtetërore në ndërtesën e Kongresit pastorit Billy Graham, senatorin John McCain dhe ish-presidentin George Herbert Walker Bush, të cilët u ndanë nga jeta këtë vit.

Ligjvënësit shpenzuan shumicën e vitit duke bërë fushatë për

rizgjedhje, por republikanët mësuan se arritja e tyre legjislative e vitit 2017 nuk krijoi entuziazëm te votuesit. "Miratimi i një ligji për një shkurtim të madh taksash për individët dhe korporatat e pasura thjesht nuk është diçka që shihet me përparësi nga shumë votues", thotë Molly Reynolds nga Instituti Brookings. Në Uashington, krerët e medieve sociale u përpoqën të riparonin demin e shkakuar nga lajmet e rreme dhe ndërhyrjet e huaja, ndërkohë që ligjvënësit po përpiqeshin të gjenin zgjidhje për probleme të reja. "Kam frikë se jemi në prag të një epoke të re të

shfrytëzimit të padrejtë në internet", tha Mark Warner, senator demokrat nga Virxhinia. Politika e ndarjes së familjeve nga administrata e presidentit Trump në kufirin ShBA-Meksikë ushqeu betejat e vazhdueshme mbi imigracionin. Presidenti Trump tha se politika ishte vendosur nga presidentët e mëparshëm, por demokratët nuk ishin dakord me këtë. "Kur presidenti tha se këto veprime nuk ishin si pasojë e vendimeve të tij, ai nuk tregoi të vërtetën", tha liderja e demokratëve në Dhomën e Përfaqësuesve, Nancy Pelosi. Dhe fati i të ashtuquajturve

Ëndërrimtarë (Dreamers), më shumë se 800 000 të rinj pa dokumente të sjellë në Shtetet e Bashkuara si fëmijë, vazhdon të jetë në rrezik. "Nuk ka logjikë që të trajtojmë një simptomë të politikës sonë të shkatërruar të imigracionit", tha Mitch McConnell, udhëheqësi i shumicës republikane në senat. Republikanët në senat kanë bërë përparim në miratimin e emërimeve të rëndësishme në sistemin gjyqësor, por kanë pasur edhe dështime. "Ne pamë se si republikanët dështuan të realizonin premtimin e tyre më të madh të fushatës në tetë vitet e fundit, shfuqizimin e Ligjit të Kujdesit Shëndetësor të ish-presidentit Obama", tha Molly Reynolds nga Instituti Brookings. Kjo shpresë mori fund kur demokratët fituan kontrollin e Dhomës së Përfaqësuesve në zgjedhjet e nëntorit për Kongres. Viti po përfundon ashtu siç filloi, me një betejë mes dy partive për financimin e qeverisë, që është dominuar nga mosmarrëveshjet mbi çështjen e imigracionit.

Maas i shqetësuar për garën e armëve bërthamore

BERLIN, 26 DHJETOR - Ministri i Jashtëm gjerman Heiko Maas ka shprehur kundërshtimin e tij ndaj vendosjes së raketave të reja bërthamore në Gjermani dhe në pjesën tjetër të Evropës, theksoi në një intervistë për DPA. Maas theksoi, gjithashtu, se ishte kundër prishjes së traktatit INF të vitit

1987, që ndalonte këto armë në Evropë. "Evropa nuk duhet në asnjë rrethanë të bëhet skenë e një debati për garën e armëve dhe vendosja e raketave të reja bërthamore do të përballet me rezistencë të gjerë në Gjermani", theksoi Maas.

Moska dhe Uashingtoni kanë

akuzuar njëra-tjetrën për shkelje të traktatit të INF-së. Një muaj më parë presidenti rus Vladimir Putin, në konferencën e tij vjetore për shtyp, foli rreth rrezikut në rritje të luftës bërthamore, duke thënë se mund të çojë në vdekjen e gjithë qytetërit dhe, ndoshta, edhe vetë planetit.



Rusia teston një armë të re supersonike

Moskë, 26 dhjetor - Kremli njoftoi se Ushtria ruse ka testuar me sukses një armë të re supersonike. Presidenti Vladimir Putin mbikëqyri nisjen e testit nga dhoma e kontrollit të Ministrisë së Mbrojtjes. Në testin e së mërkurës arma u nis nga baza e

raketave në Dombarovskiy në malet e Uralit Jugor, informon AP. Kremli bëri të ditur se arma ka goditur me sukses një objektiv të caktuar 6 mijë kilometra larg vendit të nisjes. Presidenti Putin e quajti armën e re "Avangard" duke thënë se ajo nuk mund të

zbulohet gjatë fluturimit. Arma është në mesin e koleksionit të armëve bërthamore të cilat ai i prezantoi në muajin mars. Putini tha se "Avangardi" ka një gamë ndërkontinentale dhe mund të fluturojë 20 herë më shumë sesa shpejtësia e zërit.



BeyAb for bread

Risi, tani BEYAB-in mund ta gjeni edhe nëpër dyqanet e Kosovës. BeyAb është prodhim turk, dhe përpos tregut në Shqipëri e Mal të Zi tani edhe në Kosovë.



E rrallë

Gjahtari hahet deri në kockë nga ariu që e rriti vetë

Një gjahtar rus u vra dhe u hëngër nga një ari ngjyrë kafe i cili u rrit në kopshtin e tij që kur ishte i vogël. Mbetjet skeletore të 41-vjeçarit u zbuluan nga policia e cila shkoi në shtëpinë e tij pasi të afërmit raportuan se ai ishte zhdukur dhe se ariu ishte liruar nga kafazi. Shenjat e gjakut



janë parë në borë nga sulmi fatal ndaj gjuetarit.

BARSOLETA E DITËS

Djali: Babi, sa para do të më jepje po të merrja pesëshe!
Babai: Pesë euro.
Djali: Më jep vetëm një euro, se e kam marrë njësh.

**Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC**

Në ora 16:00

“THE GRINCH” 3D,

I Animuar/Komedi/Familjar; 1 ore 30 min

Rolet: Benedict Cumberbatch, Rashida Jones, Kenan Thompson, Cameron Seely, Angela Lansbury, etj.

Regjia: Scott Mosier, Yarrow Cheney

**FOTO E DITES**

Një grua kalon pranë një posterit ku shihet një babadimër në Dubai. /AFP/

E jashtëzakonshme

Demaskohet prifti i rremë, mashtroi besimtarët për 18 vjet

Për shumë vite besimtarët në Kolumbi dhe më pas në Spanjë u rrëfyen, pagëzuan dhe bënë celebritet e martesës te një prift i rremë. Prifti mashtrues nuk u shugurua asnjëherë dhe u ekspozua pak para Krishtlindjeve. Miguel Angel Ibarra, i cili shtirej si një prift katolik romak, arriti në Spanjë në tetor të 2017-s nga Kolumbia. Ai u



vendos në detyrë në një kishë në Medina Sidonia, në jug të vendit, me vetëm 11 000 banorë. Megjithatë, në dhjetor, përpara Krishtlindjeve, famullia mësoi të vërtetën e pakëndshme: Kleriku ishte një mashtrues.

**Në ora 19:30
“MORTAL ENGINES” 3D,**

Komedi; 1 ore 51 min

Rolet: Hugo Weaving, Hera Hilmar, Robert Sheehan, Jihae, Ronan Raftery, Leila George, Patrick Malahide, Stephen Lang, etj.

Regjia: Christian Rivers

**Në ora 22:00
“HUNTER KILLER”,**

Aksion/Aventure/Fantazi; 2 ore 08 min

Rolet: Gerard Butler, Gary Oldman, Common, Linda Cardellini, Toby Stephens, Michael Nyqvist, Caroline Goodall, etj.

Regjia: Donovan Marsh




Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.

**DASHI**

Sot do të bëni zgjedhje që shkojnë ndesh me ato që vendosni zakonisht. Do të rezultojnë mjaft produktive.

**DEMI**

Këtë ditë doni të merrni përgjegjësi të reja mbi vete. Planet tuaja do t'i konsultoni me partnerin.

**BINJAKËT**

Sot do t'ju shoqërojnë gjatë ditës tuaj persona të gëzueshëm dhe mjaft të vendosur.

**GAFORRJA**

Instinkti juaj ju çon drejt një drejtimi që nuk ishte destinacioni juaj parësor. Gjithsesi është më i miri.

**LUANI**

Sot mjafton t'i ndani mirë oraret e ditës dhe çdo gjë do t'ju shkojë siç dëshironi. Parteri ka një kërkesë për ju.

**VIRGJËRËSHA**

Objektivat e ditës suaj përqendrohen vetëm te puna. Mos harroni që dhe familja ka të njëjtën rëndësi.

**PESHORJA**

Ditën e sotme duhet të gjeni aleatë të fuqishëm për të mbrojtur një projekt që ka kundërshtitë e veta.

**AKREPI**

Nëse doni të merrni në dorë fatin tuaj sot mundo-huni të qartësoni disa situata të dyshimta.

**SHIGJETARI**


Në ditët e shkuara keni bërë një gabim që do t'ju duhet pak kohë për ta rikuperuar. Gjithsesi do të dini si të veproni.

**BRICJAPI**

Sot një çështje financiare do t'ju shkaktojë shumë stres. Nëse ju kap paniku nuk do të arrini të zgjidhni gjë.

**UJORI**

Nëse keni mundësi për të mbaruar punë sot mos e neglizhoni. Koha nuk ju premtonte për të gjitha projektet tuaja.

**PESHQIT**


Keni lajme të bukura që doni t'i ndani me të gjithë. Do të gjeni disponibilitetin e personave që ju duan dhe ju mbështesin.

Johnny Depp nuk do të jetë pjesë e filmit "Piratët e Karaibeve"



Është konfirmuar edhe zyrtarisht se aktori i famshëm Johnny Depp nuk do të jetë pjesë e filmit "Piratët e Karaibeve". Prodhuesi kryesor Disney ka bërë me

dije se aktori nuk do të jetë më kapiten Jack Sparrow. Sean Bailey ka thënë se 55-vjeçari ishte përjashtuar pasi dëshironin të sillnin energji të re në film.



Tyra Banks nuk po rikthehet në America's Got Talent

Tyra Banks thuhet se nuk do të rikthehet më për ta prezantuar spektaklin American's Got Talent. 45-vjeçarja po planifikon të përqendrohet në prodhimin dhe aktrimin pas suksesit të filmit të saj, raporton

"Page Six". "Life Size 2 shkoi përtej pritshmërive. Ishte premiera e madhe e vitit. Tyra është përmbytur me kërkesa për prodhim dhe aktrim. Ajo s'do të kthehet në America's Got Talent", ka thënë një burim për "Page Six".

Si çdo vit tjetër, Jennifer Lawrence viziton spitalin e fëmijëve për Krishtlindje



Jennifer Lawrence e ka vazhduar edhe këtë vit traditën. Aktorja vizitoi spitalin e fëmijëve në Louisville, Kentucky. Aktorja 28-vjeçare, që fitoi çmim Oscar, gëzoi fëmijët për festa të martën në mëngjes. "Një falënder-

im i veçantë për Jennifer Lawrencen për vizitën në spitalin e Norton Children's Hospital", thuhet në deklaratën e lëshuar nga llogaria e spitalit në ditën e Krishtlindjeve, së bashku me një fotografi.

Mike Sorrentino festoi Krishtlindjet para burgut



Pak para se t'i afrohej dënimi prej tetë muajsh në burg, Mike Sorrentino festoi Krishtlindjet me gruan e tij Lauren Pesce. Artisti i cili u martua në nëntor ka postuar të martën

një fotografi. "Gëzuar Krishtlindjet nga Situations! Mos harroni ta trajtoni veten", ka shkruar ai nën fotografinë ku shihet me gruan me të cilën pozuan para pemës së Krishtlindjes.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN
SEKURIT
PILKINGTON
Enveri

Adri: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE

SOUTHAMPTON - WEST HAM

1

ANDERLECHT - WAASLAND

2

AL BATEN - AL QADISIYAH

2

Donjeta Sadiku dhe Patriot Behrami, më të mirët për vitin 2018

"Pasi jam shpallur kadeti më i mirë në vitin 2014, juniori më i mirë në vitin 2015, më pas më i miri edhe në 'Youth 2016', tash jam shpallur edhe boksieri më i mirë për senior. Këtë vit e kam fituar edhe çmimin e boksit më të mirë në turneun 'Adem Jashari' dhe normalisht se këto suksese më motivojnë të punoj më shumë dhe t'i shtoj sukseset në vitet e ardhshme", ka thënë Behrami



©Federata e Boksit e Kosovës

EPOKA E RE**Veton ZYMBERI**

PRISHTINË, 26 DHJETOR - Federata e Boksit e Kosovës ka shpallur më të mirët për vitin 2018. Boksierja Donjeta Sadiku duket se është e pakonkurrencë në sportin e boksit, pasi sërish është shpallur boksiera më e mirë në vend për vitin 2018, kurse boksieri me perspektivë të madhe Patriot Behrami është shpallur boksieri më i mirë. Për Behramin kjo është hera e parë që shpallet boksieri më i mirë në

kategorinë e seniorëve.

Federata e Boksit ka ndarë çmimet edhe për kategoritë e tjera. Trajneri Besim Brahimi është shpallur më i miri për vitin 2018, pasi është pikërisht ky trajner që ka sjellë medalje edhe nga arena ndërkombëtare. Epiteti i gjyqtarit më të mirë i ka takuar Latif Demollit, i cili është gjyqtar ndërkombëtar. Punëtari sportiv më i mirë për vitin 2018 është shpallur Sylejman Voca, kurse klubi më i mirë për vitin 2018 KB Gollaku.

Federata e Boksit, po ashtu, ka ndarë çmimet për kategoritë më të reja. Patriot

Behrami, pasi e ka fituar çmimin e boksierit më të mirë, ka thënë se ky çmim e motivon që të punojë dhe t'i dyfishojë sukseset në vitet e ardhshme. "Pasi jam shpallur kadeti më i mirë në vitin 2014, juniori më i mirë në vitin 2015, më pas më i miri edhe në 'Youth 2016', tash jam shpallur edhe boksieri më i mirë për senior. Këtë vit e kam fituar edhe çmimin e boksierit më të mirë në turneun 'Adem Jashari' dhe normalisht se këto suksese më motivojnë të punoj më shumë dhe t'i shtoj sukseset në vitet e ardhshme", ka thënë Behrami.

SHKURT

Shaqiri shkëlqen në fitoren e Liverpoolit

Futbollisti shqiptar Xherdan Shaqiri po vazhdon shkëlqimin në Premier Ligë. Ai ka shënuar edhe një tjetër gol që i ndihmon Liverpoolit në garën për titull të kampiones në Angli. Shaqiri luajti gjatë gjithë ndeshjes kundër Newcastle United dhe e shënoi golin e tretë në fitoren 4-0.

Drita më lart se Prishtina në renditjen e UEFA-s

Shtëpia më e madhe e futbollit, UEFA, ka zbardhur listën e ekipeve më të mira për vitin 2018. Nga Superliga e Kosovës në futboll më së miri është renditur skuadra kampione e Dritës, e cila, në sajë të koeficientit 1500, zë vendin e 372. Prishtina, e cila është fituese e Kupës së Kosovës, renditet e 402-ta me koeficient 1250. Edhe ish-kampionia, Trepça '89, ka gjetur veten në këtë listë, duke u renditur në vendin e 447 me koeficient 0.500. Në top dhjetë klubet më të mira të kontinentit evropian janë edhe Juventusi, PSG-ja, Manchester City dhe Arsenal.

Portieri i Kosovës në mesin e 20 portierëve më të mirë në botë

Edhe një herë portieri i Italisë dhe AC Milanit, Gianluigi Donnarumma, konsiderohet si portieri më i mirë i ri, një pozitë që ai e ka prej vitit 2017, por që në vitin 2017 kishte qenë i dyti. Në këtë listë është edhe portieri i Kombëtares së Kosovës dhe Manchester Cityt, Aro Muriq. Një prej lojërave më interesante online, FIFA 19, e ka vendosur portierin e Kosovës si njërin prej 20 portierëve më të mirë në këtë ndeshje. Donnaruma ka çmimin më të lartë në FIFA 19 derisa, sipas lojës, ka vlerësimin 90 apo 9. Në këtë vlerësim të FIFA 19 kosovari vlerësohet me notën 80 apo 8 dhe është një prej portierëve më të rinj nga 20 të tjerët.

KOK-u dhe ShGSK-ja organizojnë konferencën e dytë "Sporti dhe media"

PRISHTINË, 26 DHJETOR - Komiteti Olimpik i Kosovës, në bashkëpunim me Shoqatën e Gazetarëve Sportivë të Kosovës, do të organizojnë për herë të dytë konferencën "Sporti dhe media", e cila do të zhvillohet në formë panelesh. Konferenca mbahet më 28 dhjetor në "Hotel Sirius" në Prishtinë,

duke filluar nga ora 10:30. Në panele do të jenë zyrtarët më të lartë të Ministrisë për Kulturë, Rini e Sport, Komitetit Olimpik të Kosovës, federatave sportive në Kosovë, si FFK-ja, FBK-ja dhe FHK-ja, profesorë, drejtues të medieve, gazetarë sporti nga Kosova dhe Shqipëria etj. Paneli që përfaqëson institucionet

sportive (MKRS, KOK dhe federatat) do të ballafaqohet me panelin e medieve, kurse pjesë diskutimi do të jenë edhe të pranishmit përmes pyetjeve apo edhe përgjigjeve për shqetësimet e tyre në relacionin media - federata etj. Temat që do të diskutohen janë: Roli i medias karshi sportit, pasqyri-

mi i aktiviteteve të federatave në rrjetet sociale, problemet e federatave me media të caktuara, apo i medieve me federata, mosmarrja e gazetarëve (zëdhënësve) në ngjarjet ndërkombëtare, portalet, lajmet 'fake news', etj. Konferenca e parë është mbajtur në fund të vitit të



kaluar, nga e cila kishin dalë rekomandime të shumta dhe të frytshme nga panelistët dhe pjesëmarrësit.

Joshua, Wilderit: Vetëm një budalla do ta refuzonte ofertën time

LONDËR, 26 DHJETOR - Boksieri britanik Anthony Joshua, kampion i botës në peshën e rëndë në kategoritë IBF, WBA e WBO, vazhdon të këmbëngulë në një duel ndaj kampionit tjetër të botës së këtij divizioni, amerikanit Deontay Wilder. Një

sfidë që do t'i unifikonte titujt kampionë bote në një person dhe që do të zhvillohej në Londër më 13 prill (stadium "Wembley"). "Të gjithë ne e dimë se çfarë duhet të bëjmë, të duelojmë për të bashkuar titujt kampionë. Fury nuk do të jetë

kurrë gati kaq shpejt për revanshin, pasi vjen nga një pushim i gjatë dhe nuk është në formë. Ndaj ftoj Wilderin të ngjitet në ring dhe të duelojë me mua. Unë jam gati për këtë sfidë, nuk dua asnjë rival tjetër për 13 prillin veç tij", u shpreh Joshua.

"Unë e kuptoj që Wilderi është zënë ngushtë nga Fury, ndaj ka pezulluar bisedimet me mua, por është koha që ai të ndryshojë kurs. Unë i ofroj 2 duele, parë dhe mundësinë që të përballët për titujt kampionë bote. Vetëm një budalla do t'i refuzonte



kushtet e mia", ka shtuar Joshua, me 21 fitore e asnjë humbje në karrierë.

Greзда: Jam shumë i lumtur te Rangersi

GLASGOU, 26 DHJETOR - Konsiderohet një nga pikat referuese në Kombëtaren Shqiptare. 23-vjeçari nga Gjakova bëri transferimin e madh të karrierës më 2018, duke kaluar nga NK Osijek (Kroaci) në futbollin britanik. Më 31 gusht, klubi skocez i Rangersit konfirmoi nënshkrimin e kontratës katërvjeçare me shqiptarin. Prej asaj kohe, Grezda ka luajtur 667 minuta lojë, në të gjitha garat ku merr pjesë skuadra e tij, duke shënuar edhe dy gola më 11 nëntor, në fitoren e thellë 7-1 kundër 7-1 Motherwellit. "Jam vërtet shumë i lumtur dhe i kënaqur që jam pjesë e Rangersit. Mua më pëlqen gjithçka që është këtu, duke



nisur nga klubi, stafi teknik, lojtarët, tifozët dhe qyteti. Ushqimi dhe restorantet janë një pjesë tjetër, që dua ta veçoj dhe më pëlqejnë këtu. E vetmja

gjë që nuk është e mirë për mua, janë kushtet atmosferike. Megjithatë, kam filluar të mësohem edhe me to", ka thënë Grezda.

Lakersat, 'leksion' kampionëve të Golden States, Bostoni triumfon në shtesë

OAKLAND, 26 DHJETOR - Lakersi fitoi 127-101 në fushën e skuadrës kampione të Golden State, në ndeshjen e shumëpritur të Konferencës së Perëndimit, mes dy prej ekipeve pretendente për titull. Ndonëse pritej një përballje e fortë, vetëm perioda e parë ishte e ekuilibruar, pasi më tej në fushë dominoi skuadra e Lakersit. Shtatë lojtarë të ekipit të Los Anxhelosit realizuan mbi 10 pikë, me kolektivitetin që ishte arma më e fortë e Lakersit, teksa 53 pikë u realizuan nga lojtarët e stolit. LeBron James ishte lojtari më i mirë për Lakersin me 17 pikë e 13 rebounde për aq minuta sa luajti, pasi u detyrua ta lërë ndeshjen për shkak të një dëmtimi, por të rinjtë nuk u trembën dhe vijuan "kryeveprën" që nisi "king James". Mirë u paraqit edhe Zubaqi, 18 pikë e 11 rebounde, mbështetur edhe nga Rondo me 15 pikë e 10 asistime, ndërkohë që shënuesi më i mirë ishte Kuzma me 19 pikë. Pra, një skuadër me shumë pika të forta, ndryshe nga Golden State, ku loja, si zakonisht, u përqendrua te Curry (23 pikë) e Duranti (21 pikë). Kjo ndeshje tregoi se Warriorsi nuk është më i pathyeshëm dhe se Lakersi mund të duelojë për titull, rapor-



ton "Telesport". Koha shtesë i buzëqesh Bostonit, që mundi 121-114 Philadelphian, dy skuadra që duelojnë për kreun në Konferencën e Lindjes. Skuadra e Celticsit ishte më së shumti në kryesim, por në fund rrezikoi të humbiste. Mbrëmje magjike e Irvingut, autor i 40 pikëve e 10 reboundeve, që i bëri të pavlefshme 34 pikët e 16 rebauudet e Embiid për miqtë. Fiton edhe Houstoni, që mundi 113-109 Oklahoma, dy ekipe që po ringrihen gradualisht në këtë periudhë të kampionatit në NBA. Sfidë ku herë udhëhiqte njëri ekip e herë tjetri, por pesë minutat e fundit ishin vendimtarë, me

Houstonin që u shpëput e fitoi falë 41 pikëve të Hardenit. Utah Jazzi mundi 117-96 Portlandin, ndeshje ku diferencën e bëri Mitchell me 19 pikë. Skuadra e Milwaukeees mundi me lehtësi 109-95 New Yorkun jashtë fushës, sfidë ku u dallua Antetokounmpo me 30 pikë e 14 rebounde, kandidat për trofeun MVP.

REZULTATET

New York - Milwaukee 95-109
Houston - Oklahoma 113-109
Boston - Philadelphia 121-114
Golden State - Lakers 101-127
Utah Jazz - Portland 117-96

SHKURT

Essieni paralajmëron largimin e Hazardit: Çdo lojtar e ëndërron Realin

Legjenda e Chelseat, Michael Essien, e ka paralajmëruar klubin londinez se ylli belg i skuadrës, Eden Hazard, mund të largohet gjatë verës së ardhshme, pasi të gjithë duan të luajnë për Real Madridin. Hazardi nuk e ka pranuar ende ofertën e klubit të "Stamford Bridge", pasi nuk e marrë ende vendimin për të ardhmen e tij. "Hazardi është një nga lojtarët më të mirë në botë. Interesimi i Real Madridit, kam dëgjuar për këtë nga mediet. Por, dua të them, kur Real Madridi të thërret, çdo lojtar dëshiron të luajë për të. Megjithatë, ai është i lumtur në Chelsea dhe shpresoj që ajo do të mund ta mbajë", ka thënë Essien.

Emery në janar e dëshiron yllin e Sevillas

Trajneri Unai Emery shpreson të sjellë në "Emirates", gjatë afatit kalimtar të janarit, Ever Bengan. Dyshja punuan së bashku për dy sezone në Sevilla dhe Emery beson se mund ta marrë lojtarin për një shumë më të vogël se 18 milionë funte, duke siguruar shërbimet e tij dhe për ta forcuar mesfushën.

Juve ofron Sandron dhe Costan për Pogban

Juventusit është i gatshëm të përfshijë lojtarë në ofertën e vet për mesfushorin e Manchester Unitedit, Paul Pogban. Francezi kohët e fundit ka shprehur pakënaqësitë me mosinkuadrimin në ekipin e parë dhe këtë dëshiron ta shfrytëzojë kampioni italian. "TMW" shkruan se "Zonja e Vjetër" është e gatshëm të ofrojë lojtarë si pjesë e propozimit të tyre për ta ulur çmimin e kërkuar të Unitedit. Pavarësisht nga nënshkrimi i një marrëveshjeje të re këtë muaj, Alex Sandro mund të vihet në tavolinë nga Juventusit. Gjithashtu, edhe Douglas Costa mund të përfshihet në këtë ofertë gjatë javës së ardhshme për shërbimet e francezit. Për Pogban raportohet se janë të interesuara edhe skuadra kampione të botës, Real Madridi dhe Barcelona.

Kloppi: Synojmë çdo trofe










Trajneri Jurgen Klopp ka bërë me dije se synimi i tij në vitin 2019 është të luftojë për çdo trofe me Liverpoolin. "Shpresoj një skuadër më të fortë dhe me më shumë përvojë. Unë pres më shumë ndeshje speciale si këto të fundit. Do të luftojmë për çdo kompeticion që jemi në garë", ka thënë Kloppi.

Arsenali kërkon portierin e Realit

Arsenali po mendon të marrë një portier të ri, pasi Peter Cech është drejt largimit. Portieri çek ka përfunduar në stol dhe drejtuesit po shohin mundësinë për ta gjetur pasuesin e tij. Mediet angleze kanë raportuar sot se "topçinjtë" kanë nisur të lëvizin dhe i kanë vënë syrin portierit të Realit të Madridit, Kelor Navas. Pas transferimit të Thibaut Courtois, "gardiani" nga Kosta Rika ka përfunduar në stol dhe tani po e mendon seriozisht largimin. Thuhet se Arsenali është gati të depozitojë plot 12 milionë euro në arkën e kampionëve të Evropës, por nuk duket shumë bindëse oferta ekonomike, pasi realit vështirë se do ta lëshojë portierin për një shifër kaq të ulët. Mbetet për t'u parë nëse do të realizohet ky transferim, por në Angli janë të bindur se nëse nuk vjen Navasi, atëherë do të jetë Leno portieri i parë i skuadrës deri në fund të sezonit, për të mos folur më gjatë.

Luizi, afër largimit nga Chelsea

Mediet angleze janë pothuajse të sigurta se David Luizi në fund të sezonit, kur i skadon kontrata, do të largohet nga Chelsea. Mbrojtësi brazilian nuk e ka pranuar ofertën e rinovimit të ofruar nga blutë e Londrës, duke e konsideruar atë tepër të ulët krahasuar me pretendimet që ai ka. 31-vjeçari u kthye te Chelsea në vitin 2016, pasi mbylli aventurën te francezët e Paris Saint-Germainit, ku ishte transferuar në 2014-n, pikërisht duke lënë Chelsean. Për momentin nuk ka asnjë tregues për të ardhmen e mbrojtësit, por skuadrat pretendente për t'i marrë shërbimet e tij asnjëherë nuk kanë munguar.

	Autor: GAZMEND MORINA					KËNGËTARJA AMERIKANE NË FOTO (shqip.)	SHUMË, TEJ MASE	PIKA MË E LARTË NË KUPËN E QIELLIT (pashq.)	UNIVERSITY LANCASTER OHIO	TINARI	EPOKA ERE	SHTËPIZA E NDËRTUAR ME DËRRASA	ZANORE	GUR I ÇMUAR ME NGJYRË TË KALTËR OSE TË GJELBËR	PIANISTJA LULE	KËNGËTARJA MUÇAJ
	LËNG I TRASHË VESHTULLOR QË NXIRRET NGA KULLIMI I NAFTËS										PELLG I HAPËT PËR TË GRUMBULLU- AR UJË BASHKËT.					
	KËNGËTARJA EMINI												PËRGJIGJE NË TELEFON E GDHENDA			
	SHKËMB I PËRBËRË PREJ RËRE										ARBITËR BEREQET					
	LETRARI ASLLANI								METODË STUDIMI PËRSHTATJE (sh.shq.)							
	VETIA THELBËSORE E QENIEVE TË GJALLA									FLUTURUESI I PARË SIPAS MITOLOGJISË SHTET FEDERAL NË SHBA						QË ËSHTË LËNË I LIRË, PA FRE
	KALË SHALE							THIKË QË MBAHEJ SI ARMË BREZI (sh.shq.) "KENIA"						GJË E RRALLË E ME VLERË (Lat.)	ZANORE GAZ QË SHPËRTHEN KUR DIKUSH TALLET ME DIKË	
BASHKËT.							PJESË E FORTË E BUKËS "RISANI"					LLOJ BIME ME TË CILAT BËJMË PILAF				
EPOKA ERE	LOJ PËLHURË E TRASHË SI STOF	QË I MOHON NORMAT E MORALIT	AKTORJA E FAMSHME ANDERSON		VESHJE E SIPËRME PREJ SHAJAKU LLOJ LOJE FATI	MURG I VETMUAR AMPER, RENIUM						DALLGA SHOK				
DAMARI I GJAKUT									OLIVIA ZUMWALT INSTITUTE DEFENSE ANALYSES		TENISTI SAFIN BASHKËT.					
DILETANTI								IDHULLI KËNGËTARJA LIBOHOVA					"IRLANDA" KËNGËTARJA GANIMETE			GABZHERRI, GURMAZI
BIMË BARISHTORE NJËVJEÇARE QË PËRDORET SI USHQIM							FUTBOLLISTI XHEKO FUTBOLLISTI SENEGALIZ ARMAND	(QPR)			GJAKATAR KUVENDI I KOSOVËS					
AKTORJA PAPAS						KËRCELL I BIMËS SË MISRIT ZANORE						SHKRONJË GREKE NDODHEM RASTËSISHT NË NJË VEND				
DHUROJ DIÇKA				RANISHTJA PËSHTJELLIM (shq.)				ZANORE I AFRUAR		GRYKË E VULLKANIT LECKA PËR ARNIM						
HOVI, VRULLI						KËNGËTARJA AMERIKANE BAKER BASHKËT.					ANGOLA, ZAMBIA ZANORE			TITAN VAJZA E DJALIT A E VAJZËS		
EPOKA ERE	SHKRIMTARI HAZIRI	I PARI I MURGJVE NË NJË ABACI (pashq.)	BASHKËT. KAFSHË SHTËPIAKE ME TRUP E ME QAFË TË TRASHË		KLUB FUTBOLLI NË HOLANDË RADIUM, ZET				HUMORISTI THAQI PJESË E ILIRISË						BASHKËT. SIGURIM I GJËRAVE TË NEVOJSHME PËR JETESË (bised.)	
RADIOLOK- ATOR						BIMË E CILA PËRDORET PËR USHQIM RAPSDI BERISHA (shq.)					BASHKËT. ROMANCIERI GJERMAN ERIK MARIA		KËNGËTARJA JONË '... MAMA'			
LIBËR FILLESTAR								KAMPIONI MËSYMJE					ISH FUBOLLISTI BRAZILIAN ... GASPAR (ARSENAL) VEZAK			
ÇMENDURI; BUDALLA- LLËK						BABAI AMERICAN TEATRE ORGAN SOCIETY				E BITISA I NDESH						VEZË PESHKU (shq.)
ARTIOLA TOSKA			BASHKËT. BUILDING INFORMATION MODELING		REGJISTRIM NË FATURË I ÇIMITIT TË NJË MALLI SIENA							KAPI DIÇKA TE PJESA E SIPËRME NË NJË GOZHDË TEXAS EDUCATION AGENCY				
BASHKËT.		BESËLIDHËS RAMADAN AVDIU								KOB BEN AFLEK				ERNEST KOLIQI AFËRDITA DRESHAJ		
KLUB FUTBOLLI NË GREQI					BASHKË, ME TOTENHAM			SHTRATI QË PËRDORET PËR TË MBARTUR TË SËMURËT BASHKËT.							BASHKËT. ZANORE	
PËSHPËRIT DIKUJT FJALË MAGJIKE							MBULESA QË E VË DIKUSH NË FYTYRË PËR TË MOS U NJOHUR NGA TË TJERËT						DËSHIROJ			



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS/MINISTRIA E SHËNDETËSISË
VLADA KOSOVA/MINISTARSTVO ZDRAVSTVA
GOVERNMENT OF KOSOVA/MINISTRY OF HEALTH
**Agjencia e Kosovës për Produkte dhe Paisje Medicinale
(AKPPM)**
Kosovska Agencija za Lekove i Medicinska Sredstva (KALMS)
Kosova Medicines Agency (KMA)



Duke u bazuar në Ligjin e Shërbimit Civil të Republikës së Kosovës Nr. 03/L-149 dhe Rregulloren Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, **Agjencia e Kosovës për Produkte dhe Paisje Medicinale** shpall këtë:

K O N K U R S

1.Titulli i punës : Nje (1) Asistent/e Ekzekutive
Referenca : 07/2018
Lloji i pozitës : Marrëveshje mbi shërbimet e veçanta deri në (6) muaj
Orari i punës : 40 orë në javë
Mbikëqyrësi : Kryeshefi Ekzekutiv
Vendi : AKPPM-Prishtinë

Qëllimi i vendit të punës:
Mbeshketjen e punëve administrativo/teknike në zyren e Kryeshefit Ekzekutiv

Detjrat kryesore

- 1. Siguron mbeshketje te pergjithshme administrative dhe teknike perfshire posten zyrtare, telefonatat, skanimin,faksimmin dhe kopjimin e dokumenteve,plotesimin e raporteve te shpenzimeve,si dhe hartimin e dokumenteve per takime te ndryshme;
- 2. Komunikon direkt, dhe ne emer te mbikeqyresit me njesite organizative brenda institucionit per cheshtjet e iniciuara nga mbikeqyresi ;
- 3. Pergatite dhe modifikon dokumentet duke perfshire korrespondencen,raportet,memorandumet,dhe emailat per mbikeqyresin;
- 4. Pranon dhe shperndan korrespondencat per mbikeqyresin dhe kujdeset per mbarevajtjen e saj
- 5. Ruan dhe miremban sistemin elektronik dhe kopjet fizike te dokumenteve fizike dhe dosjevc te zyres se mbikeqyresit;
- 6. Menaxhon kalendarin e takimeve dhe ngjarjeve tjera per mbikeqyresin si dhe ndihmon ne zgjedhjen e ndonje problemi administrativ dhe teknik;
- 7. Ndhmon mbikeqyresin ne caktimin dhe koordinimin e takimeve te ndryshme dhe te merr pjese ne takime nese eshte e nevojshme ;
- 8. Kryen dhe detyra te tjera ne perputhje me ligjet dhe rregulloret te cilat mund te kerkohen ne menyre te arsyeshme kohe pas kohe nga mbikeqyresi;

Kualifikimi

Diplome universitare , bachelor + një (1) vite përvojë punë.

Shkathtësitë

Aftësi për të punuar me vet-iniciative në kuader të planeve dhe procedurave të përcaktuara;
Shkathtësi të mira të komunikimit ,perfshire aftësi për të interpretuar informata, dhene udhezime dhe percjelle informata tek te tjeret;
Aftësi koordinimi dhe mbikëqyrje të punës së personelit në nivelin administrativ dhe teknik;
Shkathtësi kompjuterike në aplikacione të programeve (Word,Excel,Power Point,Access);

Marrja dhe dorëzimi i aplikacioneve:

Formulari për aplikim mund të merret në Agjencinë e Kosovës për Produkte dhe Paisje Medicinale, Zyra e Personelit, (Adresa:Rrethi i Spitalit, QKUK, 10000, Prishtinë), ku edhe dorëzohen pas plotësimit. Për informata të hollësishme mund të kontaktoni me Zyrën e Personelit në numrin e telefonit: **038/20024243** prej orës **08:00-16:00**. Formulari zyrtar i konkurrimit duhet të dorëzohet së bashku me dëshminë për kualifikim shkollor, kurs të ndjekura, përvojën e punës, certifikatën (dëshminë) që s’është nën hetime dhe dy referenca. Përdorimi i formularit të gabueshëm dhe ai i pakompletuar me të dhënat e kërkuara do të konsiderohet i pavlefshëm.

“Shërbimi Civil i Republikës së Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjithë komunitetet e Republikës së Kosovës”.
“Komuniteti jo – shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike, qendrore dhe lokale, siç specifikohet në Nenin 11, paragrafin 3 të Ligjit Nr. 03/L-149 mbi Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës”.

Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim nëse arrijnë brenda 3 ditësh. Aplikacionet që arrijnë pas këtij afati nuk do të shqyrtohen fare.

Kandidatët të cilët hynë në përzgjedhje të ngushtë për intervistë do të informohen me shkrim ose me telefon në afat ligjor nga personeli.

Afati i konkursit është i hapur 8 ditë nga data e publikimit në shtypin ditor (prej datës: 27.12.2018 deri më datën: 03.01.2018 në ora 16:00).

Agjencia e Kosovës për Produkte Medicinale
Rrethi i Spitalit, QKUK, 10000 Prishtinë
Tel:+381 (0) 38 512-066
Fax:+381 (0) 38 512-243
www.akpm-rks.org



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS/MINISTRIA E SHËNDETËSISË
VLADA KOSOVA/MINISTARSTVO ZDRAVSTVA
GOVERNMENT OF KOSOVA/MINISTRY OF HEALTH
**Agjencia e Kosovës për Produkte dhe Paisje Medicinale
(AKPPM)**
Kosovska Agencija za Lekove i Medicinska Sredstva (KALMS)
Kosova Medicines Agency (KMA)



Na osnovu Zakona o Civilnoj Službi Republike Kosova, br. 03/L-149 i Uredbe br.02/2010 za procedure zapošljavanja u civilnoj službi Republike Kosova, Kosovska Agencija za Lekove i Medicinska Sredstva objavljuje:

K O N K U R S

1. Naziv radnog mesta: Jedan (1) Izvšni Pomoćnik

Referenca : 07/2018
Vrsta pozicije : Sporazum o posocbnim uslugama do (6) mesceci
Radno vreme : 40 sati nedeljno
Nadzornik : Izvšni Direktor
Mesto : KALMS-Prishtina

Svrha radnog mesta:
Podrška administrativnom / tehničkom radu u uredu glavnog Izvršnog Službenika

- Zadaci i odgovornosti:**
- 1. Obezbediti opštu administrativnu i tehničku podršku, uključujući službenu poštu, telefonske pozive, skeniranje, faksiranje i kopiranje dokumenata, popunjavanje izveštaja o troškovima i izradu dokumenata za različite sastanke;
 - 2. Komunicira direktno i u ime nadzornika sa organizacionim jedinicama u okviru pitanja koja inicira nadzorinik
 - 3. Priprema i modifikacija dokumenata, uključujući korespondenciju, izveštaje, memorandum i e-poruke za nadzornika;
 - 4. Prihvatanje i raspodelu korespondencije za nadzornika i održavanje korespondencije
 - 5. Održava i sačuva elektronski sistem i fizičke kopije fizičkih dokumenata i dokumenata nadzornog ureda;
 - 6. Upravlja kalendarom sastanaka i drugim događajima za nadzornika i pomaže u rešavanju svih administrativnih i tehničkih problema
 - 7. Pomaže nadzorniku o organizovanju i koordinaciji raznih sastanaka i po potrebi prisustvovanja sastancima
 - 8. Obavlja druge zadatke u skladu sa zakonima i propisima koje nadzornik može povremeno zahtevati

Kvalifikacije
Univerzitetska Diploma, bachelor + jedan (1) godinc radnog iskustva.

Veštine
Sposobnost raditi sa samoinicijativom u okviru definisanih planova i procedura; Dobre komunikacijske veštine, uključujući sposobnost za tumačenje informacija, pružanje saveta i prosljedjenje informacije drugima
Sposobnost koordinacije i nadzor rada osoblja na administrativnom i tehničkom nivou
Računarske veštine u softverskim aplikacijama (Word, Excel, Power Point, Access);

Uzimanje i podnošenje aplikacija:

Obrazac za aplikaciju može se dobiti u Kosovskoj Agenciji za Lekove i Medicinska Sredstva, kancelarija Ljudskih Resursi, (Adresa: Rrethi i Spitalit, QKUK, 10000, Prishtina), gde mogu se dostaviti posle popunjavanja obrazaca. Za detaljnije informacije možete kontaktirati sa kancelarijom Humanih Resursa u broj telefona: **038/20024243** od **08:00-16:00**.
Službeni obrazac za konkurisanje treba da se dostavi zajedno sa dokazom o školskoj kvalifikaciji, završeni tečajevi, radno iskustvo, sertifikat (dokaz) da nije pod istragom i dve referencije. Upotreba pogrešnog i nekompletiranog obrazca sa potrebnim podacima smatrat će se nevažećim.
“Civilna Služba Republike Kosove pruža jednake mogućnosti zapošljavanja za sve građane Republike Kosova i dočekuje aplikacije od muškaraca i žena od svih zajednica Republike Kosova”.
“Manjinske zajednice i njihovi pripadnici imaju pravo da budu predstavljениpravedno i proporcionalno u organima civilne službe Javne Administracije na lokalnom i centralnom nivou, kao sto je naznačeno u Čl.11, stav 3 Zakona Br. 03/L-149 o Civilnoj Službi Republike Kosova”.

Aplikacije poslate poštom, koja nose poštanski žig na pošiljci na poslednji dan roka za podnošenje aplikacije, smatrat će se važećim i biće uzete u obzir ako stigne u roku od 3 dana. Prijave koje pristignu nakon tog roka neće biti razmatrane uopšte.

Kandidati koji budu ušli u uži izbor za intervju bit će obavешteni pismenim putem ili putem telefona u zakonskom roku od strane personela.

Rok za konkurs je otvoren 8 dana od dana objavljivanja u novinama (od datuma: 27.12.2018 do datuma: 03.01.2019 u 16:00).

Agjencia e Kosovës për Produkte Medicinale
Rrethi i Spitalit, QKUK, 10000 Prishtinë
Tel:+381 (0) 38 512-066
Fax:+381 (0) 38 512-243
www.akpm-rks.org



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

